

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924



The Albanian



GËZUAR 2025!

VITI I 20 I BOTIMIT 23 DHJETOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

*Merry Christmas
& Happy New
Year 2025!*



The Albanian

Dotech
websites

 **Albcontacts**

**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**




The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Kur akoma nuk është shëruar plotësisht imazhi i përcudnuar i shqiptarëve të Britanisë, ndonëse numrat e ardhjeve të shqiptarëve drejt ishullit janë ulur, bëhet domosdoshmëri një reflektimi përmbytësor në këtë fundvit.

Mund të jetë shtysë, qoftë edhe ndonjë bisedë me kolegët e tu të mediave komunitare, e deri tek bisedat tejet të singërta me ndonjë shofer të rastësishëm taksie, për të

mos thënë kronikat që duket që skanë të mbaruar të kronikës së zezë për shqiptarët e Britanisë, për të kuptuar se imazhi lëngon.

‘Çunat e Londrës’ vazhdon të mbetet epitaf i një mënyre të pakapërdishmë, që mjerisht është kthyer në një referencë të patjetërsueshme, tejet frymëzuese sidomos për brezin e ri.

Pikërisht ata janë prodhim i asaj shqërie, kufatkeqësisht ndër vite, u normalizua e keqja e madje jo rrallë e keqja, po po bash e keqja, kthehet në model, ku thuajse ska vend fare reflektimi për një sistem të konsoliduar vlerash. Ndodh që sidomos përpara vizitash të ministrave të brendshëm në Londër,

DREJT NJË SISTEMI TË RI VLERASH



përhapen me shpejtësi të madhe lajmet për konfiskime pasurish të vërtetuara se janë përfituar nga rrugë kriminale. Po sikur kjo të jetë taksative, a do të ndryshonte

qasja ndaj rrugëve kriminale? Pra kushdo që të do të hynte asaj rrugë, do ta kishte të pamundur të investonte në mëmëdhe, e për rrjedhojë nuk do ta marrte atë

rrugë, apo të paktën kurrsesi nuk do të kishte këtë masivitet.

Mbase shumëkujt i kujtohet amnistia fiskale, që përmendi kryeministri shumë e shumë herë, e që e përsëriti mu në zemër të Londrës i dërguari i tij Gjijnuri.

A ishte kjo nxitje për një amnisti të heshtur dhe se paratë e kriminit mund të investoheshin lirisht në mëmëdhe? A duhet të rikujtojmë deklaratat e ish-zvkryeministrit për kanabizimin e Shqipërisë? A janë këto pasojat e drejtpërdrejta? Në këtë prag festash mbase është koha për reflektim për të gjithë ne si shoqëri, për një orientim drejt së mirës, detyrimisht për një sistem të ri vlerash. Të paktën urojmë; Gëzuar 2025!

Më shumë se 1 milion shqiptarë vuajnë nga një formë e rëndë e varfërisë, sipas të dhënave të fundit të INSTAT që matën të ardhurat dhe nivelin e jetesës në vitin 2023. Që nga viti 2018, INSTAT e mat varfërinë në përputhje me metodologjinë e Eurostat nëpërmjet treguesit "Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (ARPE) që u referohet individëve që janë në rrezik për të qenë të varfër, ose thellësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale, ose që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim.

Sipas rezultateve të fundit, Shqipëria kishte 42.1% që vuajnë nga një formë e rëndë e varfërisë. Po të marrim në konsideratë se me të dhënat e Cens 2023, popullsia e vendit ishte 2.4 milionë banorë dhe mbi 1 milion shqiptarë po përjetojnë një nga format e rënda të varfërisë. Të 1 milion shqiptarët jetojnë në familje që nuk mund të përballojnë të paktën shtatë nga trembëdhjetë kategoritë e privimit (6 kategori që lidhen me privimin në nivel individual dhe 7 kategori që lidhen me privimin në nivel familje).

Në nivel familje konsiderohen vështirësi:

1. Vonesat në pagesat e kreditë ose të qerasë për banesën kryesore, shpenzimet për shërbimet bazë, blerjet me këste ose pagesa të tjera të kredive të marra;

2. Pamundësia për të përballuar shpenzimet për pushimet vjetore një javë larg nga shtëpia;



3. Pamundësia për të përballuar një shpenzim të paparashikuar financiar me vlerën 30.000 lekë të reja;

4. Pamundësia për të përballuar një vakt me mish, pule, peshk (ose ekuivalentin për vegjetarianët) një herë në dy ditë;

5. Pamundësia financiare e familjes për mbajtjen e shtëpisë ngrohtë në mënyrë të përshtatshme;

6. Pamundësia financiare për të pasur një makinë për përdorim personal;

7. Zëvendësimi i mobilieve të vjetra me

të reje

Një individ mund të konsiderohet në vështirësi në rast se nuk ka:

1. Mundësi për të pasur lidhje interneti;

2. Zëvendësimi i rrobave të vjetra me disa rroba të reja;

3. Të kesh dy palë këpucë që përshtaten siç duhet (përfshirë një palë këpucë për të gjitha stinët);

4. Shpenzimi i një sasive të vogël parash çdo javë për veten e tij/saj;

5. Mundësia për të pasur aktivitete të rregullta në kohën e lirë;

6. Takime me miqtë/familjen për një pije/ vakt të paktën një herë në muaj.

Sipas Eurostat Shqipëria ka përqindjen më të lartë në Europë të popullsisë në rrezik të varfërisë dhe privimit material. Treguesit për Shqipërinë, sipas Eurostat, janë dukshëm më të lartë krahasuar me vendet e tjera fqinje të Ballkanit Perëndimor ku Mali i Zi ka 34.1% të popullsisë në rrezik varfërie, Maqedonia e Veriut 32.6%, Serbia 30% ndërsa për Bosnjë Hercegovinën dhe Kosovën nuk ka të dhëna. Të dhënat e Eurostat për vendet e Bashkimit Europian flasin se në vitin 2023, rreth 21.4% e popullsisë europiane ose 94.6 milionë banorë ishin në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social./MONITOR

MBI 1 MILION SHQIPTARË VUAJNË NGA VARFËRIA!

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore,
ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë
çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel: 0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



ARBEN MANAJ

Në një përpjekje për të gjetur statistika dhe bërë krahasime për të shpëtuar fytyrën në sytë e publikut britanik, qeveria aktuale laburiste, thotë se që kur kanë ardhur ata në pushtet përpara gjashtë muajsh, kanë larguar drejt vendlindjes më shumë emigrantë ilegal se në cdo periudhe gjashtë mujore në pesë vitet e fundit.

Sipas Home Office rreth 13 e 500 emigrantë të paligjshëm janë riatdhesuar pas zgjedhjeve të

qershorit. Ndërkohë që Ministrja e Brendshme thotë se kanë intensifikuar masat e sigurisë në kufi, në fakt rreth 21 e 500 vetë kanë ardhur që kur Sir Keir Stamer ka ardhur në pushtet, pra janë 8 mijë vetë më shumë të ardhur me gomone, që i shtohen numrit të të huajve ilegal në Britani, ku vetëm të enjten 607 të tjerë mbritën përmes La Manshit, dita më e ngarkuar në një dhjetor që kur kanë filluar të mbahen rekordet. Sakaq rreth 35 mijë vetë më shumë kanë ardhur me gomone gjatë këtij viti, cka përbën 20 përqind më shumë se një vit më parë, por 22 përqind më pak se në 2022, kur edhe shqiptarët e ardhur shkonin në afro 14 mijë vetë. Opozita konservatore thotë se rikthimet nuk janë për emigrantët ilegal të ardhur sesa puntorë që punojnë ilegalisht në vëndë të ndryshme pune.

ANGLI, DEBAT PËR EMIGRANTËT! ZBARKOJNË 35 MIJË VETË MË SHUMË, MEDIAT FOKUSOHET SËRISH TE SHQIPTARËT



Tabloidi The Sun madje shkruan se shumë nga të deportuarit dhe liruarit nga burgjet për drogë, si në rastin e Shqipërisë vijnë sërish pas disa kohësh në Britani për të rifilluar aty ku e kishin lanë aktivitetin e tyre kriminal. Sipas

tyre marrëveshjet me Italinë dhe Shqipërinë janë vazhdim i asaj që ne po benim, kur ishim ne pushtet. Ndërkohe Ministrja e Brendshme ka qënë në Itali këtë javë dhe ka takuar 5 homologë të saj evropiane, por pavarësisht

cejakeve dhe takimeve diplomatike, e vërtata mbetet se grupet kriminale i kanë industrializuar kalimet ilegale dhe infrastrukturën që e mundëson këtë krim. Zyratarët më të lartë britanik të sigurisë së kufijëve nuk pranojnë të prononcohen se kur do filloj ndalimi i kalimeve ilegale, pasi dukshëm krimi është disa hapa para sic tradicionalisht agjensive ligjzbatuese dhe bashkëpunimit ndërkufitar me shumë pikepytje sidomos mes Frances dhe Britanise. Rreziku me i madh si per laburistët dhe konseravtoret në fushën e emigracionit ilegal vjen nga partia e Babait te Brex-it e cila e perdor fort kartën e emigracionit ne narrtiven publike, parti e cila doli e dyta ne 98 zona elektorale në zgjedhjet e kaluara.

Dotech
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund te vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

MY **UK**
Law

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA

MY **UK**
Visas

Ne jemi të specializuar në:
Çështje emigracioni
Çështje familjare dhe divorci
Pronësi
Neglizhencë
Gjoba dhe dënime rrugore



Arta Heath

Avokate dhe Partnere Menaxhuese

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30



Huddersfield

Besmir Mujo

+44 (0) 7861 391147



Sheffield

Klodiana Gjonaj

+44 (0) 7454 819683



London

Daniel Buna

+44 (0) 7832 599757



Tirana

Dorotea Celaj

+355 69 659 8957

Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 20:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



reviewsolicitors
TRUSTED LAW FIRM



"EXCELLENT"

4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS



Ranked
TOP 10%

2024



Solicitors
Regulation
Authority



ARBEN MANAJ

Po them edhe dy fjalë për hipokrizinë ndaj Parashqevisë (Simakut).

E kam takuar diku nga fundi i viteve '80-të, në mos gabo, në kohën e përgatitjeve që bëheshin për Festivalin e Këngës në RTVSH.

Unë punoja në Redaksinë e Përendimit në Radion e Jashtme në katin e tretë të Radio Tiranes, që nga korridoret me xhama të katit shihje sheshin e brendshëm të godines që të çonte në sallën ku bëheshin përgatitjet për Festivalin.

Një ditë të bukur Parashqevia vjen në zyrën tonë dhe kemi ndejtur disa orë me të në zyrë dhe më pas në kafenenë e RTVSH.

Çfarë bukurie, çfarë personaliteti, çfarë

embëlsie tunduese ishte, sa garipe gocë dhe aq atipike për kohën!

Nuk kishte sesi të mos afeksionohesh pas personalitetit, pse jo edhe sharmit dhe fizikut të saj si njeri, si shumica e jo-hipokritëve, edhe pse e dije që ishte nëna e legjendës urbane dhe femra më e lypur e kohës!

Kaq, për këtë anë, se si kënetare ishte ajo që ishte, andaj ka lënë aq gjurmë.

Nuk e takova më pas asaj dite çuditërisht, ndryshe nga Rik Ndoci të cilit, kur fitoi festivalin i kam dhënë kollaren time dhe atë veshi në natën finale dhe fituese.

Sot Parashqevia është në hallin e saj amerikan!

Ashtu si në Shqipërinë e fundkomunizmit ajo nuk lyp asgjë!

Ajo është në hallin dhe sëkelldinë e saj private, fatkeq, por nuk ka zgjedhur të vetmëshirohet dhe nuk kërkon asnjë ndihmë, askujt!

Nëse atë nuk e ndihmojnë ata që i ka pasur më të afërt, në Amerikë a Shqipëri, për faj të saj apo atyre që dukshëm nuk e kanë dashur asnjëherë, sa ç'mund të duan siç

ndodh rëndom një qen a një mace, dhe turpi është i tyre që e kanë lenë aty ku

Ajo s'ka kërkuar ndihmë as nga individë,



është dhe nuk iu bënë ombrellë nga rrebeshi i fatit dhe hipokrizisë që vjen nga Tirana, ku shumica as e kanë njohur e as ndoshta nuk ia dinë karrierën se janë produkte të muzikës së Noizit & Co.

as nga shteti shqiptar, pasi ende ka dinjitetin e vetë, sado të sakatuar dhe poshtëruar.

Ajo jeton në një vend që shqiptarët e duan

me shumë se Shqipërinë dhe ai vend, ka sistemet e veta të ndihmes sociale.

Ndërkohë moralistë që u duket vetja "Elon Musk" të vendit më të varfer të Evropës, hiqen sikur janë të punësuar në "gofundme" dhe janë filantropet dhe fundraiser-at më të mëdhenj të globit! Parashqevisë vetëm ia kanë lypur në jetë, ajo kurrë nuk ka lypur diçka dhe askujt, e kur ajo ta bëjë, atëherë keni të drejtë të bëni barkdjegurin për të!

As atë video nuk e ka shpërndarë dhe nuk besoj se e ka inicuar ajo.

Gjithë barkprerja për të është poshtërimi më i madh publik që i bëhet asaj dhe trashëgimisë së vet artistike apo qoftë edhe përzgjedhjes së saj për të jetuar më tej atë ledh që i ka ngelur nga jeta.

Çfarëdo fondi që mund të grumbullohet nga snobllëku shqiptar, nuk ka për ta nxjerrë në breg Parashqevinë, pasi nuk është çështje parash, sesa tronditje psikologjike fatkeq apo edhe përzgjedhje e pafuqishme, apo edhe e vetëdijshme që ajo e di ekskluzivisht, e diktuar nga kjo gjendje, si shumë të tjerë në Perëndim, madje edhe në Amerikën e pasur.

Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT




The Albanian

Emigracion dhe Prona

- Aplikacione per visa bashkshortore, si te fejuar dhe visa turistike
- Heqja e Nenshtetesis Britanike
- Ankesat gjyqsore, Ndalimi pa letra ne Kampe Emigracioni dhe Urdhra Deportimi
- Aplikime per Viza Studenti dhe Viza Pune
- Aplikime per Viza ne Baza te Drejtave te Njeriut nga brenda Britanis
- Ceshtje Azii dhe Skllaveri Moderne

- Shitje dhe Blerje te Pronave
- Rihipoteka dhe Financimi i Pronave
- Dhenie me Qira te pronave Komercale
- Zgjatje dhe Rinovime te Kontratave te Pronave Komercale

Sigurojeni te ardhmen tuaj sot me keshillen e duhur profesionale ligjore!



Po Kerkoni Per Ndhime Juridike Nga Ekspert Legal?

Per me shume informacion:

Kontaktoni Partner dhe Avokate:

Oliverta Mediu

Phone: 020 7063 9040

Mobile: 079 4603 5736

Email: o.mediu@wslegal.co.uk

Address: 2nd Floor 2-5 Minories,
EC3N 1BJ

SONILA MEÇO

PARASHQEVIA, NJË MANUAL PËR TË SHPËTUAR NJERIUN NGA 'THERTORJA' PUBLIKE

Je duke pritur dikë dhe krejt papritur në rrugë, në një stacion autobusi, në një qoshkëzë pranë një shitësi ambulant ndesh një grua të mbat-hur keqaz, të lëshuar, të hutuar, të mbledhur kruspull, të vetmuar e shastisur, të pastrehë, por me një buzëqeshje e zë të njohur. Të tërheq pa kuptuar ajo fytyrë familjare, zotëruar nga shenja të pamëshirshme kohe dhe ti e di se dikur e ke dashur, dëshiruar, adhuruar, në mos po dikush i afërt yti e ka dashur, dashuruar, adhuruar.

Me kë të ngjan? Flet anglishte të përsosur.

Aktore, këngëtare? I bën një video, ia nis dikujt të afërt... merr një "uauuu" si përgjigje, pa përgjigje. "Po kjo më ngjan me dikë, mandej zëri, sytë, e qeshura nur plot dhëmbë..."

Ai tjetri ia nis atij tjetrit e tjetri tjetrit për kureshti derisa del dikush e të ndriçon. "Është filania more..."

Shtang, e pamundur... ç' do këtu?! S'ka mundësi...!

Hap instiktivisht "google", fut emrin e saj me ngut dhe lexon lajme të hershme mbi problemet e saj, ndarjen, sëmundjen, tërheqjen nga jeta publike, dramën, vetminë, zhdukjen shumëvjeçare, tronditjet dhe kujtohesh se ka bash 34 vjet në atë vend.

Çfarë do të bëje? Kur di veç hamendësimet e google-it, mungesën e saj në publik, faktin se megjithatë shumë e kanë parë dhe takuar e se nëse do kish qenë e zhdukur plotësisht, një denoncim i hershëm publik i familjarëve a miqve, pranë policisë a kudoqoftë do kish shmanjur më të keqen. Përfundimin e saj në mëshirë të rrugëve të çartura të një metropoli të dalldisur.

Ia nis këtë video një personaliteti publik, dikujt me lidhje, ndikim, me pushtet e njohje,



duke shpresuar së pari të kuptosh gjendjen e saj, shëndetin mendor e fizik. Një kontroll të mirë, një kontakt me familjen, një hetim shterues mbi rrethanat e motivet e këtij izolimi denigrues të një ylli të dikurshëm, me plot miq, të njohur, adhuruar, përfshi familjarë, që kurrë s' do kishin lejuar vetshkatërimin e saj pa strehë mbi krye, pavarësisht bollëkut të dramave e zhgënjimeve.

Ajo ishte aty, në mes të metropolit, as në një kolibe në rrafshnaltë të harruar vargmali, as në një benzinajë të ndryshkur shkretëtire tek-sane. Aty, mu aty ku kish qenë për dekada!

A kishte nevojë të niste një gjueti publike për ta shfaqur, gjykuar, analuzuar, përgojuar në atë gjendje pa emër?

Si mundet të kapitalizojë klikime, vëmendje e audiencë dikush duke i zbratur prozhektorët e harlisur në terrin e gjatë të psiqikës së saj?

A mund të numërohej deri në 100 para se t'i nënshtrohej virales në çdo cep bote kërkimi për të?

Kur në atë metropol, sado gjigand, me një fishkëllimë të njohurish e tre-katër telefonata mund të gjesh edhe vaj ulliri prej Peshtani?!

Dhe në atë gjendje pa emër, ku sindroma psiqike mund të kishin zënë rrënjë shumëvjeçare brenda asaj koke ende të bukur (ruajtur si enigmë tunduese e simbol klasi në kujtesën kolektive), a mundet një tjetër mendje e shëndetshme, logjike, e kthjellët dhe empatike ta marrë nga mizerja e rrugës dhe pa asnjë de-

likatesë ta vendosë në "thertoren" e thashethemnajës publike ku çdokush që s' di agjë di gjithçka dhe vice versa?

A e imagjinoni dhimbjen e syve, gulçimën e ankthit, stresimin e trupit, tërbimin e zemrës, therjen e stomakut, kur pasi keni ndenjmur shumë gjatë në errësirë ju plasin përballë një burimi drite, sado të ëndërruar?

Do të doja psikologë e psikiatër me përvojë të publikonin një manual të shkurtër mbi trajtimin e një rasti të tillë, si duhet prekur, si duhet t'i flitet, ku duhet të dërgohet për kurim të soocializuar, çfarë duhet t'i premtotet, si duhet ushqyer? Le të jetë një manual i shpejtë, si udhërrëfyes për këdo, që nga dëshira për të bërë mirë a nga mosdija e kureshtia po e masakron atë shpirt njeriu, dikur e përgjithmonë artiste, por edhe si një denoncim për këdo sharlatan, zemërgur, intrigant, të mangët, të ndyrë, të kompleksuar e pervers, që do të ngopë demonët e vet me shtrydhjen e dinjitetit të një gruaje fatkeqe, por në moshë madhore, që as kërkoi vëmendje, as parë, as ndihmë e as drita skene.

Në muzgun e thellë, letargjinë, dëshpërimin dhe vuajtjen e saj, kaq duhej ta kishin ditur ca mendje më të kthjellëta, se në vend të emisioneve, opinioneve, analizave publike, mund t'i kishim hedhur supeve një dorë, duke e mbështjellë me butësi e masë drejt një dritëze ndihme për t'ja lehtësuar vuajtjen, dhimbjet fizike, për t'ja mbrojtur shpirtin e bërë copë me a pa fajin e saj (askush nuk e di versionin e saktë të së shkuarës), për të kuptuar dënimin e vetes me harresë të gjatë, zhdukje pa shenjë, por pa ia prekur as kujtimin e bukur të yllit skenik, as dinjitetin e njeriut në të. Sa keq u shpërdorua çasti fatlum, megjithëse në kushte mizerabël i shpëtimit të saj!

Në autokraci është, brenda perimetrit të regjimit që lejuam të ndërtonte me "lejen" tonë.

Ndaj se mbyll tik-tok-un, pasi ka bërë të tëra, të ka vendosur shkaravinën si simbol kombëtar, se ta paketon kriminelin në zyrë publike, se çon skaletën e lajmeve në tv kombëtare, se dhuron Sazan e Dur-rës dhe shet Shëngjin, se të helmon mandarinën, se nxjerr tankun në pandemi, se të mbyll me gaz lotsjellës kur kërkon të drejtën, se mbyll media, se fjalimenton eksportues, se të dend me miell serb e kanabis vendas, se kalb fruta e perime fshati, se të gropos në beton, se të le me pension gjynahqari, se të degdis si emigrant e syrgjynos si azilant, se të zëvendëson me bangladeshas, se të bllokton trafikun, të shemb shtëpinë, të "vret" ëndrrat e të ngjall makthet e së shkuarës, ta provokon Kosovën, të vjedh votën, burgos opozitën, sekuestron shoqërinë

civile, kap drejtësinë, korrupton edhe FBI-në, të poshtëron e denigron gjersa i neveritesh vetes...prati, që merohesh se ai po bën gjëmën duke mbyllur tik-tok-un, vërtetë nuk e prisje edhe këtë?

Vërtetë kjo ta çoi indinjatën në kulm?

Më thuaj tani, 5 muaj para zgjedhjeve nuk e gjente dot një sebeb, pak kurajo e plot arrogancë të të mbyllë jo vetëm tik-tok-un, por edhe sytë...?!

Ai është në rregull me të vetën, e ka shpall autokracinë në narkoshtet.

Për mua më e rëndë qe heshtja e mësueve në atë sallë, e njerëzve, që kanë pranuar e toleruar me "ç" më duhet mua?!", sepse ai lart është në rregull me të vetën, bën aq sa e lejojmë. Ja psh, për Parashqevinë nuk lejuam ta nëpërkëmbte më askush sapo e morëm vesh, e denigruam atë botin, e nxorëm nga mizerja dhe e kemi të ftuar nderi në

NË AUTOKRACI...



festival.

Vlen më shumë kauza e saj, se jotja, që të kanë rrjepur e hedhur kripë përmbi?

Nuk besoj...epo atëherë gjeje pse Parashqevisë ia zgjidhe hallin e vetes jo. Mos më thuaj se dikush e meriton më shumë se ti. E di pse? Se ekziston e drejta e pamohueshme për një jetë dinjitoze, i/e padiskriminuar, trajtuar me respekt si i vlefshëm qofsh divë muzike, kryeministër, i pastrehë, mësues, fshatar a qytetar. Kjo është e drejtë thelbësore, që nëse nuk e di se e meriton, leri ato të mallkuara telenovela për një ditë e bëhu regjisor i jetës tënde! Sonila Meço

QUALITY

BUDGET FRIENDLY CLINIC

HEALTHCARE

- Same day Appointment
- Well-Being + Gender Scans (16 Week)
- Weight Loss Injections
- Hearth Check-Up
- Health Check-Up
- Botox & Filler & Skin Booster & PRP
- Hair - Loss Mesotherapy Injection

Need a trusted North London GP? Medplus Clinic offers private, convenient healthcare that fits your busy life.

Book appointment via phone or online, choose your time, and enjoy same-day appointments at our easily accessible location near Silver Street Station, Angel Corner-Edmonton. Quality care, in and out in under 30 minutes. Visit Medplus Clinic today!



Medical Services

- GP Consultation
- Paediatric Consultation
- Cardiology Consultation
- Dermatology Consultation
- Gynaecology and Obstetrics Consultation with Ultrasound
- Psychiatry
- Check-Up
- Ear, Nose, Throat (ENT) Consultation
- Ultrasound Scan
- Counselling & Psychotherapy
- Skin Examination
- Injection (without medication)
- Ear Wax Removal
- Psychology



Aesthetic Services

- Migraine Botox
- Masseter Botox
- Underarm (Armpit) Botox
- Filler for Cheeks
- Filler for Nasolabial Folds
- Filler for Marionette Lines
- Chin Filler
- Lip Filler
- Jawline Contouring with Filler
- Non-Surgical Rhinoplasty
- PRP (Platelet-Rich Plasma) Therapy
- Skin Rejuvenation
- Mesotherapy
- Skin Boosters
- Dermapen
- IV Vitamin Drip
- Glutathione Treatment
- IM Vitamin Injections
- Fat-Dissolving Injections
- Hair-Loss Mesotherapy Injections



CHOOSE US FOR :

- ✓ Specialized Expertise
- ✓ Diagnostic Services
- ✓ Vaccinations
- ✓ Holistic Care
- ✓ Check Up



MORE INFORMATION



02082927485



07440014118



www.medplus.org.uk



175 Fore Street
Edmonton London
N18 2XB

Monday - Saturday 9 AM - 6 PM

10% OFF

Stay Connected, Save More with Medplus Clinic! Get £20 OFF just for following us on Facebook or Instagram, and enjoy 10% OFF all treatments at Medplus Clinic.

Follow us for exclusive savings on quality care in North London. Book now!

Follow Us:



medplusclinic



medplusclinic



MedPlus Clinic



Silverstreet Station



Angel Corner



Car Parking

NDREK GJINI

“Malet e Gjigantëve”, me autor Carleton S. Coon, është një nga veprat më të veçanta dhe më të vlefshme për studimin e Gegëve të Malësisë të Veriut të Shqipërisë.

Ky libër, i cili është një studim i thelluar racor dhe kulturor, u botua fillimisht në anglisht në vitin 1950 si pjesë e serive të Peabody Museum të Universitetit të Harvardit, por iu mohua padrejtsisht publikut shqiptar për më se 70 vjet.

Me përkushtim dhe me një standart të lartë përkthimi, Ambasador Mal Berisha e ka sjellë këtë vepër në gjuhën shqipe, duke ruajtur thelbin, strukturën dhe autenticitetin shkencor të këtij libri.

Dhe unë e ndjej veten me fat që Ambasador Mal Berisha më ftoi të bëhëm pjesë e këtij projekti me kaq vlerë, duke më besuar rolin e redaktorit të këtij libri.

Përmbajtja dhe Vlerat Shkencore të Librit

Libri përfshin studime të thelluara mbi strukturat shoqërore, organizimin familjar, sistemet e martesave dhe ritet tradicionale të Gegëve të Malësisë të Veriut. Carleton Coon ka ofruar një analizë të hollë antropometrike, duke përfshirë matje trupore të mbi 1,000 individëve dhe duke i lidhur ato me mjedisin natyror, zakonet dhe ndikimet kulturore.

Një nga temat kryesore të librit është fenotipi unik i Gegëve të Malësisë, i karakterizuar nga elemente që reflektojnë vazhdimësinë ilire dhe dinarike. Ai analizon ndikimet gjenetike dhe kulturore që kanë ndihmuar në ruajtjen e këtyre tipareve përmes shekujve, pavarësisht izolimit gjeografik dhe sfidave historike.

LIBRI “MALET E GJIGANTËVE”
NJË PËRKTIM MJESHTROR NË STIL DHE NË QASJE GJUHËSORE NGA MAL BERISHA
VEPËR E ANTROPOLOGUT TË MADH AMERIKAN CARLETON. S. COON


Përkthimi mjeshtror i Mal Berishës Përkthimi mjeshtror nga Ambasador Mal Berisha është një vepër në vetvete. Si një bir i Malësisë të Gjakovës, ai ka punuar me një pasion dhe kërkim të thellë shkencor në interpretimin dhe përshkrimin e materialit origjinal. Berisha ka ruajtur jo vetëm thelbin shkencor të librit, por edhe ndjeshmërinë kulturore dhe gjuhësore që përmban kjo vepër.

Përkthimi i tij është i pasur në detaje, duke siguruar që termat dhe konceptet antropologjike të jenë të kuptueshme për lexuesit shqiptarë. Një element i veçantë është fakti që tabelat dhe ilustrimet origjinale janë përfshirë në botimin shqip, duke i dhënë studiuesve një mundësi të rrallë për të shqyrtuar burimet e plota të këtij studimi.

Në parathënien e tij, Berisha ndan motivet e tij personale që e shtojnë atë të angazhohej në këtë përkthim. Ai thekson rolin e tij si një avokat i kulturës dhe traditës shqiptare, duke i dhënë lexuesve shqiptarë një dritare për të kuptuar dhe vlerësuar trashëgiminë e tyre.

Kontributi Historik dhe Kulturor i Coon dhe Berisha

Dr. Carleton S. Coon ishte antropologu i parë që zhvilloi një studim kaq të gjerë dhe të thelluar mbi Gegët e Shqipërisë së Veriut. Ai kaloi muaj të tërë në terren në vitet 1929-1930, duke studiuar jetën e përditshme të Gegëve, matjet trupore dhe traditat e tyre.



Nga ana tjetër, Mal Berisha e ka ringjallur këtë vepër për lexuesin shqiptar në një kohë kur nevoja për vlerësimin dhe ruajtjen e trashëgimisë sonë kombëtare është më e madhe se kurrë. Puna e tij kontribuon në fuqizimin e identitetit kulturor shqiptar dhe në promovimin e tij në arenën nderkombëtare.

Stili dhe Qasja Gjuhësore

Një nga pikat e forta të përkthimit është qartësia dhe rrjedhshmëria e gjuhës shqipe që përdor Berisha. Ai ka arritur të balancojë terminologjinë teknike me një stil të kuptueshëm,

duke i bërë konceptet e ndërlikuara shkencore të arritshme për një publik më të gjerë.

Përveç kësaj, Berisha ka ruajtur një ton të respektueshëm ndaj popullit shqiptar dhe kulturës së tij, duke nënvizuar vlerat unike që Coon zbuloi dhe dokumentoi në këtë studim. Ai gjithashtu ka shtuar shënime të detajuara që ndihmojnë lexuesin shqiptar të kuptojë kontekstin e veprës origjinale.

Një Trashëgimi Që Duhet Vlerësuar “Malet e Gjigantëve” është më shumë se një libër shkencor; është një dokument që përshkruan thelbin e kulturës shqiptare në një periudhë të veçantë

historike. Ky botim që erdhi në shqip, falë punës së palodhur të Mal Berishës, është një pasuri e vyer për të gjithë ata që dëshirojnë të kuptojnë më thellë rrënjët e identitetit tonë kombëtar.

Ky libër është një urë mes së kaluarës dhe së ardhmes, mes traditave të ruajtura dhe botës moderne. Falë Coon dhe Berishës, “Malet e Gjigantëve” mbetet një testament i fuqishëm i pasurisë së trashëgimisë sonë kulturore dhe një shembull i shkëlqyer në studimin shkencor të kulturës shqiptare dhe prejardhjes Iliro-dardane te gegnise shqiptare

KLODIAN TOMORRI

Në harkun kohor të dy viteve, eksportet e kompanive shqiptare jashtë kanë rënë me 1 miliardë euro. Për të njëjtën periudhë, importet e Shqipërisë nga jashtë janë ulur me 400 milionë euro.

Me pak fjalë, krahasuar me vitin 2022, Shqipëria ka sot një deficit tregtar 600 milionë euro më të madh. E megjithatë, përgjatë kësaj kohe, leku është forcuar me 16.1 për qind ndaj euro s.

Sa herë që u duhet të shpjegojnë këtë paradoks, zyrtarët e qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë rendin pas varkës së madhe të shpëtimit. Ky është turizmi. “Janë rritur të ardhurat nga turizmi, dërgesat nga emigrantët dhe investimet e huaja direkte,” është refreni magjik me të cilin drejtuesit e shtetit shpjegojnë fuqinë mistike të lekut.

Në fakt, të gjitha këto janë më të vërtetë një varkë e madhe shpëtimit. Të ardhurat që Shqipëria përfiton nga turizmi janë vlerësime, ashtu si dërgesat e emigrantëve. Shifrat e tyre mund të

kalibrohen sipas nevojës sepse janë të pamatshme, një proces që anglezët me delikatesë e quajnë “fine tuning”.

Fjala vjen nëse qeveria dhe Banka e Shqipërisë i deklarojnë nesër të ardhurat nga turizmi 10 miliardë euro, askush nuk ka për të marrë vesh asgjë. Dhe avash avash po shkojnë aty. Tani të kthehemi tek të dhënat që vlejné. Të ashtuquajtura “hard data”. Këto janë të dhënat, që janë të matshme, të verifikueshme dhe të besueshme. Teksa totali i të ardhurave që Shqipëria deklaron zyrtarisht se ka përfutur nga turizmi kanë arritur mbi 5 miliardë euro, hotelet e vendit në vitin e tyre më të mirë kanë deklaruar vetëm 350 milionë euro xhiro në deklaratat e TVSH-së të dorëzuara në Tatisë.

Lulëzimi i Airbnb, apo shpenzimet e tjera të turistëve jashtë hoteleve, nuk mund të shpjegojnë dot një diferencë kaq të madhe. Dhe gjithkush ka të drejtën të ngrejë pyetjen; sa të be-

sueshme janë shifrat që Shqipëria deklaron për turizmin? Por le t'i marrim për një moment të mirëqëna të gjitha.

Problemi është se as dëfterët e bakallit turistik nuk po e justifikojnë dot më fuqinë e pamposhtur të lekut. Merrni vetëm atë që ka ndodhur vitin e fundit. Në bilancin e pagesave, ekziston një tregues, i cili regjistron të gjitha transaksionet ndërkombëtare që Shqipëria kryen me pjesën tjetër të botës, përveç llogarisë financiare dhe asaj kapitale. Kjo është llogaria korrente, e cila përfshin brenda saj si shkëmbimet tregtare ashtu dhe turizmin, dërgesat e emigrantëve e madje edhe shkëmbimet e shërbimeve të tjera. Në nëntë muajt e parë të vitit të kaluar deficiti i llogarisë korrente ishte 22.6 milionë euro. Pra nga Shqipëria kanë dalë 22.6 milionë euro më shumë se sa kanë hyrë. Për 9 muajt e parë të këtij viti, deficiti i llogarisë korrente u përkeqësua me më shumë se 10 herë duke arritur në 230 milionë euro. Por

për të njëjtën periudhë leku u forcua me 5.6 për qind ndaj euros. Pra as turizmi nuk po i gjen dot më derman forcimit të lekut.

Paralelisht flukset e llogarisë financiare, po ashtu janë përkeqësuar. Me të vërtetë Shqipëria ka shënuar rritje të investimeve të huaja direkte, por për të njëjtën periudhë, investimet e kompanive shqiptare jashtë shtetit janë rritur edhe më shumë. Efekti i SPAK, efekti i kursit të këmbimit apo ngushtim i diferencialit të kthimit nga kapitali me shqipërisë dhe ekonomive të zhvilluara, kjo pak rëndësi ka. Por flukset valutore neto të investimeve direkte janë më të ulëta.

Me pak fjalë, transaksionet që ekonomia shqiptare kryen me botën janë me bilanc negativ në të gjithë komponentët. Kjo do të thotë se nga Shqipëria del më shumë euro se sa hyn. Por prapë, leku forcohet.

Tani le të kthehemi tek pyetja themelore. Nga buron fuqia e lekut, kur

as turizmi, as emigrantët dhe as investimet e huaja nuk e shpjegojnë dot më. Kjo është një pyetje që nuk ka përgjigje racionale. Dhe aty ku shkenca nuk shpjegon dot, fillon territori i hyjnore. Fuqia e lekut është hyjnore. Vetëm kështu mund të shpjegohet. Ndoshta Edona nuk e kishte keq kur e krahasoi kryeministrin me Zeusin. Ndonëse në këtë rast, krahasimi më i mirë do të ishte me Hadesin, Zotin që qeveriste botën e nëndheshme. Kjo përbën më shumë sens. Ndoshta vendi ku duhen kërkuar arsyet e forcimit të lekut nuk është bota e sipërme që duket, por ajo poshtë që nuk duket. Bota, që qeveris Hadesi.

Dhe kjo është një botë shumë e madhe, e cila shtrihet nga Amsterdamit në Bruksel e madje deri në Dubai. Me korporata dhe korrierë të cilët lëvizin lumenj valute. Por shifrat e tyre nuk dalin në dëfterët e qeverisë, edhe pse të gjithë qeverisen nga Hadesi i Edonës.

ARMAND SHKULLAU

Kontrolli në banesën e Erion Veliajt, më shumë se pikëpyetje për fatin e tij personal, ngriti një pikëpyetje të madhe për fatin e vetë SPAK dhe drejtësisë së re. Hetimi për kryebashkiakun e Tiranës, i cili prej shumë kohësh e ka vendosur SPAK-un në një udhëkryq kompromentues, ndoshta është guri i fundit për të shenjuar definitivisht rënien e prokurorisë së posaçme.

Çështja Veliaj, së bashku me dosjen e famshme të Elbasanit, janë dy rastet par excellence që mishërojnë arsyet pse u ngrit SPAK dhe se, a i përmbush kjo strukturë pritshmëritë dhe shpresën e qytetarëve. Ato janë anatomia perfekte e kapjes dhe rënies së një shteti. Një prokurori e posaçme, e shëstuar me investimin e bujshëm të amerikanëve, u motivua pikërisht me nevojën jetike të vendit për t'u çliruar nga dy fenomene të paprekshme: Krimi i Organizuar dhe Korrupsioni.

Duke lënë mënjanë çfarë është thënë e nuk është thënë për prokurorët e SPAK, ata tashmë kanë në dorë dy simbole që janë kuptimi i vetë ekzistencës së kësaj strukture. Mënyra se si do të sillen ndaj tyre, ose do të varrosë përfundimisht idenë e "di pietrove" shqiptarë që i kanë duart e lira dhe të pastra për të vepruar, ose mund të rikthejë besimin se investimi për këtë prokurori ia ka vlejtur. Deri më tani, shenjat tregojnë se SPAK nuk e ka as forcën e as vullnetin për të bërë "heroin" e drejtësisë shqiptare.

Dosja e Elbasanit është afëra tipike dhe mbase më kulmore e mpleksjes së krimit të organizuar, politikës, drejtësisë dhe medias. Një organizatë e fuqishme kriminale punon për të sig-

SUEL ÇELA DHE ERION VELIAJ, ANATOMIA E RËNIES SË SPAK

uruar vota për partinë në pushtet, paguan tanxhete për zyrtarë të lartë të drejtësisë, rrëmben tendera me para publike, shfrytëzojnë pushtetin politik për të goditur rivalët, etj. Për SPAK emrat dhe bëmat e kësaj bande kanë

Megjithatë, duke shfletuar këtë dosje, pavarësisht vonesës, SPAK ka përsëri në dorë t'u ekspozojë shqiptarëve anatominë e trupit të kalbur të një shteti që kontrollohet nga krimi. A do

Deri tani, SPAK nuk ka dëshmuar ndonjë vullnet në këtë drejtim. Ndonëse prej disa vitesh janë denoncuar si krimi në Elbasan ashtu edhe lidhjet e tij me eksponentë lokalë e

e krimit të organizuar, bashkia e Tiranës është anatomia e korrupsionit. Një kupolë e tërë drejtuese që përvetëson paratë publike duke i kaluar në llogari të kompanive të veta private.

Një hemoragji financiare e përditshme që kap dhjetra miliona euro për një incenerator që nuk ekziston. Edhe këto abuzime të denoncuar nga media dhe opozita prej disa vitesh, e përsëri SPAK e merr shtruar pavarësisht se kemi të bëjmë me rastin tipik të korrupsionit në nivelet më të larta. Pra me një nga arsyet e ekzistencës së vetë SPAK.

Si në rastin e Elbasanit, përsëri hetime të zvarritura, njerëz në detyrë që mund të prishin apo fshehin prova, dëm financiar që vetëm rritet.

Dhe kur e krahason këtë modus operandi me shpejtësinë hetimore marramendëse të tentativës për korrupsion të Safet Gjicit për një strehimore qensh, e kupton që "heronjtë" kanë prioritet interesin politik dhe jo interesin publik.

Janë pikërisht këto dy raste tipike, që ilustrjnë edhe vetë emrin e bujshëm të SPAK, që sot e kanë vendosur atë në udhëkryqin final të vazhdimësisë. Qasja ndaj dosjes së Elbasanit dhe aferës Veliaj, do të përcaktojë ose një kthesë të re në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit ose rënien përfundimtare të "heronjve të fëmijëve tanë". Jo në fushën e betejës por në shtratin e martesës me pushtetin.



qenë të njohura të paktën tre- katër vite më parë.

Pjestarët e saj kanë vepruar hapur në Elbasan, duke sfiduar rendin në sajë të mbështetjes politike që gëzonin. Prokurorët specialë priten përgjimet që erdhën nga Belgjika, i mbajtën ato në sirtarë për një kohë të gjatë dhe nisën hetimet kur protagonistët patën kohën e duhur ose për t'u larguar ose për të pastruar gjurmët.

jenë në gjendje prokurorët të zbrëthojnë mekanizmin e votave për të cilat Suel Çela thotë se i duhen Ballës?

A do të arrijnë të shkojnë tek milionat e eurove me të cilat Rilindja qeraste bandën pas përfundimit të zgjedhjeve? A do të kenë këllqe të hetojnë edhe brenda vetes nëse organizata e Elbasanit i ka shtrirë tentakulat edhe aty?

qendrorë të Rilindjes, prokurorët specialë ende nuk po dëshmojnë se duan t'i shkojnë atij deri në rrënjë. Në vend të emrave me pushtet, ata devijuan vëmendjen tek dy gazetarë, sipas de vizës shumë zhurmë për asgjë.

Afera Veliaj, është ana tjetër e medaljes që do të duhej të justifikonte ekzistencën e SPAK. Ajo e korrupsionit. Nëse dosja e Elbasanit është anatomia

LISANDËR HOXHA

Shqipëria sot po përballlet me një krizë të thellë vlerash. Në vend të promovimit të edukatës, meritokracisë dhe shpresës, qeveria aktuale ka zgjedhur të shpërblejë antivlerat dhe të mbajë pushtetin përmes propagandës dhe manipulimit. Një shembull i freskët i kësaj është vendimi për të mbyllur TikTok-un, një platformë që i ka shërbyer të rinjve për t'u shprehur lirish dhe për të shpërndarë të vërtetat që qeveria nuk dëshiron të shihen.

Qeveria e Ramës pretendon se kjo masë ndërmerret për të parandaluar dhunën dhe bullizmin mes të rinjve. Por a nuk është paradoksale që të njëjtët njerëz që shpërblejnë këngëtarët dhe figurat publike që promovojnë dhunën dhe degradimin moral, tani pretendojnë të mbrojnë rininë? Ata që kanë lejuar që kultura e krimit të dominojë, që kanë kthyer deputetë dhe kryebashkiakë të ardhur nga bota e krimit në "modele suksesi", sot janë të njëjtët që gjoja shqetësohen për ndikimin negativ të TikTok-ut.

ANTIVLERAT QË SUNDOJNË SHQIPËRINË: PSE MBYLLJA E TIKTOK-UT ËSHTË NJË ALIBI E RAMËS PËR ZGJEDHJE



Sot Shqipëria renditet në fund të Evropës për cilësinë e arsimit. Ky është pasqyrimi më i qartë i një qeverisje të dështuar, e cila ka degraduar institucionet e dijes dhe ka lejuar korrupsionin të bëhet normë. Pedagogët që shesin nota dhe drejtuesit që favorizo-

jnë të paafët po shkatërrojnë çdo mundësi për zhvillim dhe po detyrojnë të rinjtë të largohen nga vendi.

Korrupsioni në arsim nuk është vetëm një problem etik, por një model i gabuar që qeveria ka promovuar në çdo sektor. Si mund të presim që rinia të zg-

jedhë rrugën e dijes dhe punës së ndershme kur shembulli që u serviret është ai i politikanëve të korruptuar dhe kriminelëve të promovuar?

Mbyllja e TikTok-ut: Një vendim politik, jo një masë mbrojtëse

Mbyllja e TikTok-ut nuk ka asnjë lidhje me sigurinë e fëmijëve apo përmirësimin e arsimit. Është një përpjekje e hapur për të kufizuar lirinë e informacionit dhe për të bllokuar qarkullimin e videove që ekspozojnë të vërtetat e errëta të qeverisë. Ndryshe nga Facebook-u dhe platformat e tjera ku censura e Ramës është më e lehtë, TikTok-u mbetet një hapësirë që qeveria nuk mund ta kontrollojë.

Rama nuk mbyll TikTok-un për të mbrojtur nxënësit, por për të mbrojtur pushtetin e tij. Ai e di që videot e skandaleve të tij dhe qeverisë së tij janë një

kërcënim i drejtpërdrejtë për fushatën e ardhshme zgjedhore. Paniku i tij është i dukshëm, sepse çdo ditë e më shumë po bëhet e qartë që largimi i tij është i pashmangshëm.

Zgjidhja: Përmbysja e këtij sistemi dhe rikthimi i shpresës

Shqipëria nuk ka nevojë për mbyllje platformash apo censurë. Ajo ka nevojë për një reformë të thellë që fillon me largimin e kësaj qeverie. Duhet të promovojmë vlera të vërteta: ndershmërinë, meritokracinë dhe edukimin. Duhet të krijojmë një sistem ku të rinjtë të shohin shembuj pozitivë dhe të ndihen krenarë për të qëndruar dhe për të ndërtuar të ardhmen e tyre këtu.

Koha e Edi Ramës ka mbaruar. Koha e ndryshimit është tani. Shqiptarët meritojnë më shumë. Le të përmbysim këtë sistem që promovon antivlerat dhe të rindizim shpresën për të ardhmen!



FOR SALE

RESTORANT PËR SHITJE
5 minuta nga Tower Bridge
I hapur prej vitesh
Me klientelë të garantuar



FOR SALE

RESTORANTI NDODHET NË NJË
ZONË SHUMË TË PASUR ANGLEZE

I PAJISUR ME TË GJITHA
LIÇENSAT



FOR SALE

PËR MË SHUMË INFO
KONTAKTONI:
07393453904

AGIM NESHO

Kurti është një politikan që është admiruar për karakterin e tij të fortë dhe qëndresën për çështjen kombëtare. Ai ka meritën e madhe që i rezistoi presionit për të pranuar projektin e Ballkanit të Hapur, projekt që do të sillte dominimin serb në Ballkan, duke anashkaluar Kosovën dhe rrezikuar një realitet të ndryshëm gjeopolitik në Ballkanin Perëndimor, jashtë perspektivës Europiane dhe nxitjen e influencave të fuqive autokrate për rritjen e zonave të tyre të influencës.

Ajo që i ka munguar qeverisë dhe shtetit në Kosovë është se ajo i ka përballuar këto sfida e vetme, edhe kur regjimi i Edi Ramës në Tiranë kishte zgjedhur si partner Vucicin e Beogradit për të qenë aktorët e preferuar të zgjidhjeve pragmatiste në Ballkan dhe realizuar pushtetin e tyre autokratik.

Kurti nuk ka gabuar kur e ka mbajtur larg Ramën, por jo Shqipërinë. Jo se ai është një figurë kontraversiale, protagonist, por sepse Rama ka mbajtur pozicione të qarta anti-kombëtare, si në përkrahje të skenareve ruso-serbe të ndryshimit të kufijve, të Ballkanit të Hapur, të presioneve ndaj Kosovës për të pranuar cdo kërkesë që aktorët të komunitetit ndërkombëtar shprehin



në favor të lehatimit të regjimit nacionalist të Beogradit, që dhe ai “të merrte dicka”.

Kurti dhe Osmani kanë pasur të drejtë kur kanë parë se regjimi i Tiranës ju ka mbyllur derën për kërkesat legjitime të Kosovës për dënimin e genocidit serb në Kosovë; kur Rama njohu Veriun e Kosovës si “tokë e askujt”; të mos pranimit të sulmit terrorist në Banjskë si një sulm i sponsorizuar nga Beogradit, e deri në vendosjen e sanksioneve i pari ndaj Kosovës

dhe vetë-propozimit të draftit të Asociacionit të komunave serbe.

Ai i ka tallur dhe përbuzur liderat e Kosovës në sy të Vucic-it, kur ata kanë qëndruar për atë çfarë besonin. Ai ka projektuar skenarë së bashku me Vucic dhe ka shijuar verërat e Serbisë, kur regjimi i Beogradit përgatiste dosjet kundër udhëheqësve të UCK-së. Miqtë e Ramës që ai i do, i sajdis dhe bashkëpunon edhe në dëm të interesave Shqipërisë, ishin ata që votuan kundër pranimit të Kosovës në Këshillin e Europës

KURTI NUK MUND TË LEGJITIMOJË PASHIÇIN NË KOSOVË

(Partia e Melonit, Orbanit, parlamentarët e Serbisë) etj. Politika e tij e jashtme “plot suksese” është një politikë klienteliste që shtypi prestigjioz ndërkombëtar e quan justifikim të mafiokracisë.

Kurti dhe institucionet e Kosovës e pranuan aktivitetin e përbashkët të kuvendeve të dy shteteve, për arsye të presionit të brendshëm, që marrëdhëniet midis dy qeverive janë në nivelin më të ulët. Për më tepër, që treguan përgjegjshmëri për të pranuar një bashkëpunim thelbësor me Shqipërinë, kur interesat sovraniste

të Kosovës vihen në rrezik. Por sjellja e Ramës ishte sjellja e një demagogu, që jep këshilla për të evidentuar “largpamësinë dhe neutralitetin e tij”.

Ai përmend Rugovën, kur në takimin e mëparshëm e mohoi veprën e tij duke detyruar përfaqësuesit e LDK-së të linin parlamentin; Këshilloi qeverinë e Kosovës të ngrijë dialogun me Serbinë, kur deri tani ka kërkuar të kundërtën;

Kërkoj rezolutë për Gjykatën Spe-

cialë në Hagë për demagogji, kur dihet se ai dhe Vucic janë inisiatorët e gjykatave për t’ju hapur rrugë pushtetit të tyre të pakufizuar në Shqipëri dhe Kosovë me një drejtësi të komanduar.

Takimi i djeshëm ishte një shfaqje e panevojshme, që duhej shmangur përpara atdhedashurisë së një populli të tërë që kërkon bashkim të faktorit Shqiptar dhe unitet në veprim. Pa një reflektim për politikën e deritanishme nga Rama dhe dënim të politikave shoviniste të Vucic për hapësirat serbe, cdo gjë do të mbetet një shfaqje.

Kurti dhe partitë e tjera opozitare duhet të kuptojnë që Kosova do të marrë frymë vetëm atëherë kur të shkatërrohet lidhja Rama-Vucic dhe projekti i tyre për Ballkanin që i mban në pushtet.

Ai nuk mund të legjitimojë Ramën, jo si diktatori i ri i Shqipërisë por si një Pashic i ri që me të drejtë gazetar i mirënjohur gjerman, Martens, e ka quajtur “Rama - kryeministri më i mirë i Serbisë”.

ALFRED LELA

Mbyllja e një platforme të komunikimit masiv me pretekstin se rrezikon jetën e nxënësve është një masë qeveritare absurde, që e kërkon zgjidhjen aty ku nuk është. Vendimi i shpallur nga kryeministri Rama, me gjasë pas vrasjes së 14 vjeçarit Martin Cani nga një bashkëmoshatar, jo vetëm që nuk adreson thelbin e problemit, por hap një të ri. Krijon një sistem censure që me masa ndëshkimore dhe ndalimore kërkon të rregullojë arealin e komunikimit masiv, duke cënuar një prej lirive themelore të njeriut, shprehjes.

Nëse rasti Cani do të kishte qenë vërtetë shtysa e kësaj mase ndëshkimore autoritare z. Rama ka disa alternativa para se të shkojë te ndalimi total i platformës Tik tok. Së pari, mund të ndalojë përdorimin e të gjitha rrjeteve sociale në sistemin shkollor elementar dhe të mesëm në vend.

Së dyti, ashtu si Australia, mund të ndalojë përdorimin e Tik tok, te Facebook apo Instagram për shetasisit nën 16 vjeç.

Secila nga këto masa do të ishte më e përshtatshme dhe do të adresonte problemin nga i cili lindi shtysa për ndalimin e Tik tok, pra do u hiqte nxënësve të shkollave një ‘armë të ftohtë’ konflikti verbal dhe vizual, që



më vonë mund të kthehej në fizik. Fakti se Rama nuk ka zgjedhur ndalimin e pjesshëm, por të përgjithshëm, e bën masën të bjerë era politikë dhe përlogaritje elektorale. Për disa arsye.

Së pari, Tik tok është platforma me algoritmin më demokratik ndër rrjetet ekzistuese sociale. Kjo mundëson një shtrirje më të gjerë dhe më intensive

të materilait të postuar aty dhe, rrjedhimisht, shikueshmëri dhe ndikim më të madh.

Së dyti, ndryshe nga Facebook, një platformë e cila ka dëshmuar një vullnet të qartë për të bashkëpunuar me qeveritë e ndryshme, përfshirë edhe shqiptaren, Tik tok deri më tash ka qenë më e hapur, më pak e ndikuar dhe më rezistente ndaj vendosje së al-

goritmeve kontrolluese.

Duke qenë e tillë Tik tok ka prodhuar një efekt të tretë duke u bërë shpejt një platformë e preferuar e shpërndarjes së imazhit dhe mesazhit.

Për sa i intereson kontekstit shqiptar, me Ramën në të, Tik tok është shndërruar në një platformë të shpërhapjes së mesazhit kritik me qeverinë. Në një vit elektoral një mjet i tillë i pakontrolluar i komunikimit masiv, nuk parapëlqehet nëpër këmbë. Kështuqë, Rama përdori pretekstin e vrasjes së një 14 vjeçari për të instaluar një masë jodemokratike dhe censuroese ndaj kritikëve apo kundërshtarëve politikë.

Nuk është hera e parë që Kryeministri bën përçapje të tilla. Për disa vite rresht ai pat ngulmuar për një projektligj të ashtuquajtur të shpifjes, i cili në thelb nuk ishte gjë tjetër veçse përpjekja për të kufizuar apo bllokuar mediat e reja-portalet- të cilat nuk i kontrollonte dot.

Beteja e Tik tok është vetëm një për-

pjekje për të kufizuar platformat e komunikimit apo mediat e pakontrolluara prej tij.

Pretendimi i Ramës është jo vetëm hipokrit, por edhe grotesk. Të fajësosh Tik tok për gjithë sherrin që çoi në përplasjen fizike dhe vrasjen me thikë nga një adolshent të një vërsniku është si të thuash se ke parë në radio një film. Tik tok nuk është platformë e shkëmbimit me tekst, dominanca e tij është te videot apo imazhet dhe shpërndarja e tyre, pra nuk është platformë e tekstit si Facebook apo e shkëmbimeve të mesazheve si ehat-sapp apo snapchat. Do të thotë Tik tok nuk ka qenë platforma ku adolshentët janë grinder, gjë që konfirmohet edhe nga vetë kompania, e cila përgënjeshtoi kryeministrin Rama, duke thënë se nxënësit në fjalë nuk ishin aktivë në Tik tok.

Duke ditur këtë, Ramës i mbetet në dorë përpjekja autoritare dhe e pandershme për të kufizuar komunikimin e kritikëve dhe kundërshtarit politik. al

RASTI “TIK TOK”: KUSH HUMB ÇELËSAT E SHTËPISË, KËRKON TË KYÇË GJITHÇKA

NAIL DRAGA

Vetëm në pluralizëm qytetarët në vendet e ish kampit socialist kanë pasur mundësi të njihen me dukurinë e kohabitacionit. Kemi të bëjmë me përfaqësuesit e pushtetit të cilët nuk i takojnë partisë së njëjtë në institucionet kryesore të vendit siç janë presidenti dhe kryeministri. Në këtë aspekt një dukuri e tillë është e pranishme në Mal të Zi nga viti 2020, duke vazhduar edhe tash si një model i qeverisjes. Nga ai vit në Mal të Zi në pozita të tilla kemi të bëjmë me dy president dhe tre kryeministra, të cilët janë përpjekur për „kompromise“ të cilat dëshmojnë se kohabitacioni është realitet shoqëror në pluralizëm. Ndryshime jo vetëm programore

Opinion i gjerë është i informuar se kohabitacioni aktual në Mal të Zi është pasojë e ndarjeve të brendshme të partive duke u trajtuar si papajueshmëri personale. Por, me kalimin e kohës del qartë se kemi të bëjmë ndryshime në aspektin ideologjik e programor, nga del se kemi diferencim në dy pozitat me të rëndësishme shtetërore. Nga aspekti i demokracisë një qendrim i tillë nuk paraqet dobësi, por e kundërta, sepse me reagime nga ana e presidentit kemi të bëjmë me kontrollë të pushtetit ekzekutiv, dukuri e cila më parë ka qenë shumë e rrallë.

E kaluara nuk mund të harrohet

Nga 30 gushti 2020, kur u bë rotacioni i pushtetit në Mal të Zi, kur pas tri dekadave kaloi në opozitë DPS-i, në skenën politike janë të pranishme kalkulimet e ndryshme të subjektëve politike të cilët nuk zgjedhin mjete për të qenë pjesë e qeverisjes si në nivelin lokal e ate qendror. Ish opozita e cila tash është në pushtet në këtë aspekt përveç përvojës së tyre kanë mësuar shumë nga partia e cila ka udhëhequr për tridhjetë vite(DPS), madje në disa çështje edhe duke iu tejkaluar.

KIM MEHMETI

Sado që dua të përmbahem, nuk ia dal të mos bërtas e të mos ndjej turbullira në bark kur dëgjojë përfaqësues të VLEN-it, përndryshe kryetar komunarash e funksionar të lartë të deridjeshëm të BDI'së, si i kritikojnë bashkëpartiakët e vet të dikurshëm për zhatjen e pamëshirshme që ia kanë bërë popullit?!

Pra që mendojnë, e mbase edhe besojnë, se mjafton ta ndërrosh partinë, se mjafton të mbulolesh me emblemë të re partiake që populli të harrojë si ke dhënë leje për ndërtim duke ua marrë banorëve lejen për të jetuar njerëzishëm.

Dua të mos merrem më me mjerimin tonë politik, por si të heshtësh kur ndjen si ta plasë barkun ai ish kryetari i komunës, e tani deputet i BDI'së, që e shndërroi në gërmadha Liqenin Treska, si kërkon shqyrtim të pa-

Por, duke marrë parasysh se e kaluara nuk harrohet, pas datës 30 gusht 2020 pothuaj të gjitha subjektët politike në nivel lokal e ate qendror refuzojnë që në koalicion të ftojnë DPS-in, sepse ata janë përgjegjës për qeverisjen e vendit në të kaluarën.

Demokracia e pakonsoliduar

Jo rrallë në skenën politike në Mal të Zi, nuk respektohen parimet demokratike ku subjektu politik me numër më të madh mandatësh duhet të propozojë kryetarin e të tjerët pozitat tjera sipas mandateve të fituara. Por, ndodhë e kundërta, partitë e vogla, kushtezojnë për të qenë pjesë e koalicioneve, madje edhe duke kërkuar më shumë se realisht iu takojnë. Një veprim i tillë nuk ka të bëjë fare me parimet demokratike, por me interesin e subjektëve të ndryshme politike, duke kushtëzuar subjektin më të votuar. Mos arritja e koalicionit për formimin e pushtetit lokal si në Podgoricë dhe Budva, është dëshmi transparente e një konstatimi të tillë.

Numrat si kushtëzim

Askush nuk mund të mohojë rëndësinë e numrave, sidomos kur është në pyetje formimi i koalicionit qeverisës, por kushtëzimi për pozita të veçanta, paraqet kërcënim politik ndaj partisë politike më të madhe. Dhe nga një veprim i tillë arrihen kompromise të dhimshme, vetëm për hir të qeverisjes në mjedisin përkatës. Ne raste të tilla, parimet demokratike humbin vlerat e

surisë së politikanëve, me çka dhembjes së zhatjes ia shton edhe atë të përbuzjes.

Shkurt, njeriu nuk mund të përmbahet e të mos klithë kur përballet me diçka aq të paturpshme sa të bënë të ndjeshëm i mjerë dhe të pyesësh veten: si mund të heshtin njerëzit e 'ditur' të këtij populli kur dëgjojnë e shohin si këta opozitarë e pozitarë tan që i lindi e njëjta nënë – BDI'ja, jo vetëm që të zhvatën por edhe të përbuzin e të mbanjnë për budalla!

Ku ta dish mbase ata e kanë kuptuar atë që unë do vdes e kurrë nuk do e

KOHABITACIONI DHE QEVERISJA - SHQIPTARËT NË MAL TË ZI



i cili u verifikua nga kuvendi i Ulqinit me 30.5.2024.

URA pësoi dy autogola

Një veprim i tillë nga URA ishte befasi për opinionin sepse koalicioni këto dy vite ka funksionuar mirë, duke arritur suksese në aspektin financiar, por edhe në disa projekte zhvillimore. Por ambiciet për pushtet dhe animoziteti ndaj disa individëve ndikoj që të mos respektohet marrëveshja ku vendimtarë ishte rotacioni në lidhje me kryetarin re komunës. Me këtë veprim politik URA pësoi dy autogola, duke u vetpërgjatur jashtë qeverisjes lokale si dhe riktheu DPS-in në pushtetin lokal në Ulqin. Në mënyrë identike një dukuri e tillë ka ndodhur edhe në komunën e Beranës, sepse duke mos respektuar rotacionin e kryetarit, dhe të pamundësisë të formojnë një koalicion të ri, është bërë shpërndarja e parlamentit lokal dhe është shkuar në zgjedhje të parakohshme lokale që janë mbajtur me 8 dhjetor 2024.

Interesat jo vetëm individuale

Janë pikërisht veprimet e tilla të subjektëve të ndryshme politike me numër të vogël këshillatresh apo deputetësh të cilët kanë kërkesa të palogjikshme, por shfrytëzojnë momentin për tu treguar gjoja të rëndësishme, edhe e pse e dijnë se pesha e tyre reale në skenën politike është e

ulët. Dhe deri sa të kemi pjesëmarrës të tillë në skenën politike, demokracia pluraliste ka humbur vlerat reale, sepse eliminohen parimet demokratike sepse në skenë janë të pranishme interesat e grupeve apo të individëve të ndryshëm.

Nga qeverisja qytetare të ajo partiake Pikërisht nga një situatë e tillë në qeverisjet lokale por edhe ate qendrore janë punësuar individë të ndryshëm, që me përjashtim të rastëve, pjesa dërmuese tyre janë militant apo individë të tjerë që iu përkasin ekskluzivisht partive politike. Por raste të tilla nuk respektohet kriteri i profesionalizmit dhe meritokracisë, por përshtatshmëria dhe nepotizmi nga del se shumica e kuadrave partiake, janë për të dëshiruar.

Nëse me herët koncepti i qeverisjes trajtohej qoftë edhe formalisht si i qytetarëve, tani e ka humbur tërësisht atë kuptim sepse kemi të bëjmë me qeverisje partiake, e cila ka marrë përmasa të virusit të përgjithshëm shoqëror, me pasojë për të tashmën dhe të ardhmën.

Konkurset pa peshën e duhur

E dhëna se individë të ndryshëm nga subjektët partiake të koalicionit përcaktohen më parë se sa të shpallet konkursi publik, e dëshmon në mënyrë transparente një konstatim të tillë. Pikërisht, nga një situatë e tillë dëshpruese kuadrat e verifikuar dhe të dëshmuara mbesin jashtë mundësive për tu punësuar, sepse në rënd të parë është përkatësia dhe përshtatshmëria partiake se sa profesionalizmi e meritokracia.

NGA HAJDUTË TU NUK MUND TË TË SHPËTOJË ASNJË LISTË E ZEZË AMERIKANE, POR VETËM VETËDIJA JOTE!

marr vesh: se këtë popull nuk ka kush e mbron, andaj ai i ngrati është pajtuar me fatin e të zhvaturit dhe të përbuzurit.

Pra mbase ky popull edhe ka harruar se nga burrshtetasit tu hajdut e të pafytyrë nuk mund të të mbrojnë e shpëtojnë asnjë listë e zezë amerikane, por vetëm vetëdija dhe guximi yt qytetarë!

Dhe mbase ky popull edhe nuk ka forcë të përballet me të vërtetën se, sikur listat e zeza amerikane t'i përfshinin të gjitha të zezat që i janë bërë këtij populli, ne ndoshta do mbeteshim pa politikanë?!



TRI SHEMBUJ PËR ARROGANCËN E PAPËRBALLUESHME TË NJË AMERIKANI

ANDI BUSHATI

Me rastin e 5 vjetorit të SPAK, atij që në një farë mënyre mund të quhet si krijesa e tyre, zv sekretari amerikan i shtetit, Alexander Kananof, erdhi në Tiranë të celebronte sëbashku me prokurorët e posaçëm dhe me krerët e drejtësisë në këtë vend.

Ndonëse një zyrtar në largim, si pasojë e rezultatit të zgjedhjeve të nëntorit të shkuar, diplomati amerikan nuk e kishte lënë pas krahëve arrogancën tipike të të dërguarve të perandorisë në një provincë të humbur të saj.

Në afro tetë minuta fjalim ai dha së paku tre shembuj në formë, mesazh politik dhe imponim kushtetues, nga ato që hasen vetëm në republikat e bananeve.

Z. Kananof e filloi fjalën e tij dikur rikujtuar medaljen që shefi i tij në krye të diplomacisë amerikane, i dha Altin Dumanit, në 9 dhjetor në Uashington, me motivacionin si kampion kundër korrupsionit.

Natyrisht, pavarësisht përkrahjes apo kritikave që mund të ketë gjithësecili, ky qe një vlerësim i amerikanëve për punën e këtij institucioni. Por, ama nga këtu e deri te cilësimi i këtij evenimenti si “një ditë e madhe për popullin shqiptar”, është një hendek i pa kapërcyeshëm.

Me çfarë lehtësie një zyrtar tranzitor mund ta shpallë atë si ngjarje të veçantë për mbarë një komb? Të tilla mund të konsiderohen fitorja e një lufte, një datë çlirimi, nënshkrimi i një marrëveshjeje të rëndësishme, si fjala vjen anëtarësimi në NATO apo në BE, por jo një ceremoni e lobuar politike.

A mund ta shpinte nëpër mend SHBA-ja ta bënte këtë me një vend di Franca, Italia apo qoftë edhe Hungaria, e jo më pastaj ta shpallte edhe ditë të madhe për ata popuj? Natyrisht që është e paimagjinueshme. Por, ajo ndodh nga menësia e të trajtuarit si turma delesh të popujve që magjepsen si indianët e dikurshëm nga dhurimi i pasqyrave.

Kjo qasje është pjellë e të njëjtit mentalitet me atë që e yshti ish ambasadorin Yuri Kim, të caktonte edhe se cilët ishin “heronjtë e fëmijëve tanë”. Sa do qesharake që të duket, ekzistojnë vërtet mbi këtë rruzull diplomatë të prekur nga sindroma e Lorencit të Arabisë, që besojnë se mund të përcaktojnë hierarkinë e vlerave të një shoqërie. Ky i sotmi ishte një rast tipik.

Por, këmbëngulja për të shpallur “një ditë të madhe për shqiptarët” është vetëm ana më sipërfaqësore dhe e padëmshme e fajlimit që mbajti Z. Kananof. Më i rëndë qe fakti se në një



ceremoni që i përkushtojë drejtësisë së pavarur, ai gjeti rastin të bëjë propagandë pro Edi Ramës.

Njësoj si sekretari Anthony Blinken, që kur vizitoi Tiranën nuk pati pikë droje ta etiketonte atë si “një udhëheqës të shquar” dhe “kryeministër shumë të mirë”, vartësi i tij u tregoi prokurorëve: “Dëshëroj të vlerësoj drejtimin e kryeministrit dhe qeverisë së tij që ka prodhuar një përparim të madh në reforma”. A e dinte ai që teorikisht Edi Rama është i dyshuar në disa dosje të SPAK, që nga ajo McGonigal, koncesionet në shëndetësi, vendimarrja për inceneratorin e plot të tjera? A qe ky një mesazh adresuar spakistëve se të gjithë politikanët janë të barabartë, por ka disa që janë më të barabartë se të tjerët?

Për një shtet vërtet sovran kjo lloj arrogancë duhet të qe e papranueshme. Vështirë se në ndonjë tjetër vend, anë-

tar të NATO-s, do qe toleruar mbledhja e njerëzve të drejtësisë për t’u thënë atyre se shefi i qeverisë është një personazh pozitiv, pra në thelb i paprekshëm.

Me të njëjtën shpërfillje që jepen sinjale për personazhe të paprekshëm, kushtetuta e këtij vendi trajtohet jo vetëm si e prekshme, por më keq, si një leckë e arrnueshme. Kjo u pa në pjesën e fjalimit kur, me një lehtësi të papërballueshme, diplomati amerikan kërkoi një ndryshim në ligjin themeltar të shtetit, për të zgatur qëndrimin në detyrë të prokurorëve të SPAK. Në nenin 184/d të kushtetutës përcaktohet shprehimisht se mandati i tyre është 9 vjeçar dhe i pa rinovueshëm.

Natyrisht hartuesit e reformës në drejtësi kanë pasur arsytet e veta që kanë vendosur kështu. Disa prej tyre mund të kenë pasur merakun për të mos i dhënë atyre fuqi të përhershme

ekstraligjore. Për të mos i bërë të ndihen të paprekshëm dhe fuqiplotë. Për të mos krijuar në thelb një “republikë prokurorësh”. Ndërsa tani, SPAK dhe Dumani pretendojnë se puna e tyre shkatërrohet po u ndërprejnë mandatet. Se dëmtohet vazhdimësia e hetimeve, përvoja e krijuar dhe në thelb, lufta kundër krimit dhe korrupsionit.

Çështja nga ana praktike dhe juridike mund të hajë diskutim. Disa mund të shqetësohen se SPAK-u dobësohet, ndërsa disa të tjerë se ai mund të ngrihet mbi ligjin. Pikërisht për këtë, dikush që reket të të japë një këshillë, mund të sugjerojë se ky diskutim duhet hapur, se argumentat pro dhe kundër duhen debatuar, e kështu me radhë.

Por në vend të kësaj, Z. Kananof urdhëroi me një arrogancë të paparë: këtë duhet ta bëni. Pyetja që shtrohet është: pse në vend të këshillës miqë-

sore, ai zgjodhi pozicionin dominant të një padroni?

A mundet që në një vend normal të urdhërosh trajtimin e kushtetutës si një leckë? A mund t’i konsiderosh njerëzit aq idiotë, sa edhe tu predikosh se reforma në drejtësi është një histori suksesi, por njëkohësisht të kërkosh çdo pesë vite ndryshimin e rregullave të saj të lojës?

Në të tre këto raste nuk ka logjikë, por imponim; nuk ka dialog, por urdhër; nuk ka bshkëpunim, por forcë. Trajektorja e shkurtër, që nga predikimi se çfarë duhet quajtur ditë e madhe për një popull e deri tek mospërfillja për të përdhosur kushtetutën e tij, janë ilustrimi i një Amerike që nuk jep shembull përmes vlerave, por dominon nëpërmjet frikës. Anën me të errët të kësaj superfuqie e shfaq vetëm brenda tetë minutave, zyrtari i një administrate në largim.

PËRTEJ RRUGËS SË KOMBIT, ASGJË E RE...

NDUE DEDAJ

-Kur mund të ishte “zonë e lirë” ekonomike mes Shqipërisë dhe Kosovës-

Njerëzit e paktë të maleve, edhe ata të qyteteve ndër male, presin me zemër të ngrirë a do të ketë fund ikja? Braktisja? Turravrapi drejt gjithëkudit, por jo kthimi drejt maleve? Thënë ndryshe, a do të ketë fund, fundi? Malet nuk i begenisin më as vetë malësorët, le pastaj investitorët, përfshi edhe ata strategjikë. Kurse qeveritarët gjenden aty ku janë “përqendruar” votat, jo te pjesa tjetër e Shqipërisë, ajo pa vota. Lë t’i ketë ajo “tjetra” pasuritë natyrore, mirëpo ajo nuk ka vota!? As në zgjedhjet e 11 majit 2025 nuk do të ndodhë ndryshe.

Në pushtet vihet me vota e rrihet me vota, e ato janë dhe larg vendit, në Milano, Londër, Selanik, Shtutgard, Nju Jork, por jo më në malet tona. Kaq e thjeshtë është “historia” e tranzicionit shqiptar, malet i ka zënë shterpësia e votës dhe kësaj ato nuk mund të (ri)lindin. Doemos, jo të gjithë e kanë lëshuar vendin e tyre, janë një dorë njerëzish idealistë, vullnetmirë, por nuk mjaftojnë. Atyre sikur po iu rrëshqet “dheu” nën këmbë përditë e më shumë.

Njerëzit e votuar të pushtetit vendor, kur janë të qeverisë e çojnë rrugën në Dukagjin dhe mirë bëjnë, ndërsa kur nuk janë të saj (mazorancës), nuk e çojnë dot as deri në Orosh, 10 kilometra matanë Rrugës së Kombit! Janë, po ashtu, përherë aty misionarët e fesë, si pararendësit që shkruan “Formulën e Pagëzimit”, por që malet nuk i pagëzuan dot me frymën e tyre të pashembullt iluminuese. Janë disa bij të vendit që pasi punuan disa vite në emigracion dhe mësuat kulturën e punës e të biznesit, u kthyen në vendin e lindjes për të bërë agroturizmin e suksesshëm. Janë dhe disa të rrallë donatorë të huaj, që ende besojnë në të ardhmen e maleve shqiptare, qofshin këto dhe Tranga në lartësi e Kanioni i Urakës në thellësi.

Janë folkloristët që i këndojnë dheut të tyre me pasion, ani se shpesh duke e glorifikuar katundin e kullën, fisin e bajrakun. Por, nuk janë të rinjtë më atje, edhe pse e kanë dashurinë për malet e të parëve të tyre, ata sapo hedhin shtat “fluturojnë” jashtë, mbaruar e pa mbaruar shkollën e mesme. Përtej këtyre, të tjerët që ngjiten në male janë “gjuetarët” e thesareve të natyrës, faunës, florës, pyjeve, ujërave, mineraleve etj.. Ekzotika në vetvete nuk vlen, por ende nuk është krijuar besimi se investimet mbi këto pasuri sjellin mirëqenie për banorët, përpos për investitorët e tyre. Dhe besimi nuk krijohet me premtime, por me vepra të dukshme në dobi të komunitetit. Teksa udhëton nëpër Mat me makinë, ndërrohesha me vargun e trajlave të ngarkuar me krom, që vijnë nga Bulqiza e shkojnë në portin e Durrësit.



Njëri nga vendësit u shpreh se me kaq shumë krom që kalon këtu thuajse çdo ditë, prej më shumë se dhjetë vjetësh, kjo rrugë duhet të ishte shtruar me flori e jo të jetë e pakalueshme në aksin Burrel-Rrëshen. Edhe ku rrugët janë të rëndësishme e në zë, asgjë e re përtej tyre. Prej 15 vitesh, zor se mund të kishte një zonë agroindustriale më të përshtatshme se ajo në të dyja anët e Rrugës së Kombit. Por nuk është parë si e tillë.

Nga Miloti deri në Kukës, rreth 100 km, nuk ka resorte e bujtina turistike, vende për të bërë ski, rezervate kafshësh të egra etj., edhe pse bjeshkët e Oroshit dhe të Fanit janë të pazakonta për nga larmia e relievit, pasuria natyrore e bukuria, por edhe me ndonjë xhevahir të rrallë arkeologjik e monumental si Gurra e Domgjonit e Guri i Xhuxhës. Duke mos pasur se ku të venë – në Nënshajt, Xhuxhë, Lajë e Kaçinarit, Munellë a Kunorë – ka familje mirditase që këtë fundviti do ta kërkojnë borën në Kolashin të Malit të Zi, pasi shumë nga bjeshkët tona me bujtina, përfshi dhe ato të Kosovës, i kanë frekuentuar më parë. Pa kurrfarë idealizimi, lugina e Fanit në Mirditë mund të ishte dhe duhet të jetë më e begata në Shqipëri, krahas asaj të Vjosës. Po përfundon një qendër agro-përpunimi në Rubik, ndërkohë që mund të kishte disa të tilla.

E jo vetëm lugina e Fanit, por edhe

bjeshkët e Lumës e Hasit. Nikolin Jaka, presidenti i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë thotë se korridori i Rrugës së Kombit duhet të shndërrohet në një “kantier” i agroturizmit për punësimin e njerëzve në hoteleri, restaurante, prodhimin bujqësor, mbarëshkrimin e blegtorisë etj.. Njerëzit presin që të jetë shteti nxitësi, mbështetësi dhe promovuesi i progresit rural. Por nuk dimë sa zyrtarët e nëpunësit e ministrisë së Bujqësisë ngjiten në bjeshkët e Pashtrikut për t’u “takuar” me dhinë e famshme të Hasit, që na e solli aq mirë përmes emisionit të saj “Bagëti e Bujqësi” gazetarja e pasionuar Rudina Muça. Bariu i njërit nga tufat kishte qenë dy vjet emigrant në Greqi e dy në Gjermani dhe në fund kishte zgjedhur bjeshkën e tij për të punuar, që mbase s’mund ta bëjë shumë të pasur, por do ta pasurojë shpirtërisht. Nga fermerët e atjeshëm mbarështoheshin dhe lopët, pulat etj.. Njëri nga banorët, që ka ngritur buzë liqenit një fermë blegtorale, synon që të ndërtojë një agroturizëm dhe të sjellë dy djemtë e tij nga Anglia që të punojnë në vendlindje.

Ky është sa amaneti i të parëve, aq edhe thirrja bashkëkohore naimjane e vendlindjes. Fat që kemi kamera televizive që shohin shumë më larg se kryeqyteti, i mbytur në rutinën e kronikës së zezë mediatike e politike. Lajmet e Tiranës hapën e mbyllën, kush hyri sot e nesër në SPAK, si doli ekspertiza e armës së ftohtë me të cilën u krye iks krim, hollësira që i

nevojiten hetimit e gjyqit, po kurrë publikut, të cilin, përkundrazi, lajme të tilla me thika, bomba, tritol, kallash e shokojnë!? Ashtu si seancat e përditshme me fyerje e gjer përplasje fizike deputetësh në Kuvend.

Në malet tona i has të dyja anët e medaljes, edhe njerëz që punojnë duke parë nga e nesërmja, edhe nga ata që ende nuk kanë vendosur të rrinë, edhe pse nuk shohin ndonjë mundësi atje ku duan të venë. Nikolla nga Shëngjergji ka guxuar si rrallëkush të ngre një fermë lopësh në lartësi të bjeshkës, 50 km larg nga qyteti, me mbi dyqind krerë të mëdha e të vogla, rreth 50 krerë derra, 70 koshere bletësh, ndërkohë që në verri ka 13 dynym vreshta me rrush “Kallmet” i bardhë.

Ai me mjetet e tij kujdeset dhe mirëmban rreth 15 km rrugë malore, çka duhet ta bëjë shteti, teksa ky i fundit nuk i afron asgjë 62-vjeçarit për zgjerimin e biznesit të tij familjar, që punëson disa veta. Ermali në Perlat merret me mbledhjen dhe gatimin e kërpuhave bio në resortin e tij agroturistik, duke vlerësuar çdo bimë apo pasuri tjetër që ka zona. Kujtimi po aty kujdeset për bletët e tij që të prodhojnë mjaltë pa “hile”. Albani në Bruç kultivon troftën me ujë e Shutrrisë, ku ka krijuar dhe një resort familjar mikpritës. Por, ata e të tjerë e ngrysin ditën me “mallkimin” e rrugës, që bizneset e tyre i lë jashtë mundësive për t’u frekuentuar, edhe pse njerëzit marrin rrugën që nga Tirana.

Teksa pinim një kafe te bar “Tarzani” në Burrel me miq matjanë, shprehëm kënaqësinë që do të nisë asfaltimi i rrugës për në Macukull, fshatin e kullave rrëzë Dejës, që më 1992 kishte 610 nxënës në arsimin 9-vjeçar e të mesëm, por dikush prej tyre ishte skeptik, duke dyshuar se mos bëhej fjalë për “asfalt elektoral”, përdërisa rruga për në Urakë, vetëm pak kilometra matanë qytetit, është gjithë gropa(!). Njëri nga bashkëbiseduesit “trëmbëhet” dhe ngre zërin sikur ka përballë të zotët e punës, që nuk bëjnë punë të “vogla”: “O qeveritarë, mbushni ore gropat e rrugëve, nga Jugu në Veri dhe mos prisni të bëhen të pakalueshme, që pastaj t’i tenderoni me tendera të majmë!” I bashkohemi dhe ne zërit qytetar për rrugët, që disa janë të nënës e disa të njerkës, përkatësisht qeverisë dhe bashkisë. Kjo ka bërë që “topi” i fajit të hidhet këndeje e andej. Burokracia e rrugëve është e pashembullt, me shkresa e kundërshkresa mes institucioneve qendrore e vendore, se kush duhet të mirëmbajë këto apo ato rrugë, të klasifikuar si nacionale apo rurale etj..

Banorët nuk duan të dinë për këso ndarjesh, ata po nuk ua bëre rrugën ikin. Qeveria ka shpallur vitin 2030 për hyrjen e Shqipërisë në BE, por me këtë gjendje të infrastrukturës në zonat malore, zor se Europa do të mbyllë njërin sy! Kur flasim për rrugët, e para është kryerruga, ajo e Kombit, me të cilën ndërlidhen të tjerat. A mund të jetë ajo një si “zonë e lirë” ekonomike mes Shqipërisë dhe Kosovës? Nëse po, atëherë, pas ca vitesh, do të kishin kuptim ato krahasimet e bjeshkëve të Mirditës, Kukësit e Pukës me Zvicrën, Austrinë etj.. E nuk është vetëm agroturizmi, por dhe bazaltet e Rubikut, bakri i Spaçit, kromi i Kalimashit etj.. Por, dini ndonjë zonë të lira ekonomike, që të mund të shpresohet për këtë? Qe përfolur para pesë vitesh një e tillë në Kashar, të cilën e pati deklaruar vetë kryetari i Bashkisë së Tiranës, në një sipërfaqe rreth 50 ha. Por asgjë e re, asnjë gjurmë e ndonjë sipërmarrjeje të tillë. Është vetëm “zona e lirë” e palleteve të pafundme, që po zgjatën drejt Vorës.

Asnjë park i gjelbër për njëqind mijë banorët e Astirit e më gjerë. Asnjë shkollë, kopsht, çerdhe, qendër sociale, bibliotekë, librari etj.. Rroftë zona e lirë e babëzisë së ndërtimeve në kryeqytet, a thua se Tirana do të jetë streha e Ballkanit!? Kur mendon se Rruga e Kombit nis nga Tirana e Durrësi, për të mbërritur në Prishtinë, atëherë thua se dy qeveritë mund të kishin një projekt të përbashkët për investime strategjike në mbarë këtë hapësirë strategjike kombëtare

AURENC BEBJA

Daily Express” ka botuar, të mërkurën e 2 korrikut 1930, në faqen n°8, intervistën ekskluzive asokohe me Mbretin Zog I në Shqipëri.

Zogu – një mbret shumë modern
Burimi : Daily Express, e mërkurë, 2 korrik 1930, faqe n°8

Nga Alexander Levvey Easterman

Mbreti Zog refuzon të mbajë një kurorë
Nuk do të ketë ceremoni kurorëzimi
Personalisht mbikëqyr çdo departament të shtetit të tij

Mendon se gratë duhet të qëndrojnë jashtë politikës dhe është idhulli i popullit të tij

Tiranë, Shqipëri.

Sapo pata një intervistë të gjatë dhe magjepsëse me një Mbret të ri të mrekullueshëm, i cili, megjithëse ulet në fronin e mbretërisë më të re, më të vogël dhe më pak të njohur evropiane, mund të ketë fuqinë për të ndaluar ose për të shkaktuar shpërthimin e ardhshëm të luftës në Evropë. Kërcënimet dhe sfidat e zjarra por të paqarta të Musolinit gjatë ditëve të fundit do të kenë një kuptim më të qartë në dritën e vendit të këtij Mbreti në Ballkan.

Zogu, Mbreti i parë i Shqipërisë, është një risi tek monarkët. Ai është i vetmi sundimtar që refuzon të mbajë një kurorë. Ai refuzon, kundër këshillës së ministrave të tij, të ketë një ceremoni kurorëzimi, sepse është shumë i zënë me ndërtimin e shtetit të tij dhe sepse kostoja e ceremonisë, thotë ai, mund të përdoret më mirë në rregullimin e mbretërisë së tij. Ai personalisht drejton çdo departament të shtetit të tij, nga politika e jashtme e lartë deri tek ndërtimi i një rruge të re në kryeqytetin e tij. Ai është autokrat i padiskutueshëm i vendit të tij dhe idhulli i popullit të tij.

Mbreti Zog është vetëm tridhjetë e tre vjeç. Dy vjet më parë, kur ai ishte një qytetar privat, ai krijoi, i vetëm, Mbretërinë e re të Shqipërisë nga një rrëmujë tipike kaotike ballkanike e fraksioneve të panumërta të vogla dhe fiseve ndër-luftuese – një ferr grindjesh politike, revolucionesh dhe grindjesh të vazhdueshme. Ai ngriti fronin e tij dhe krijoi një dinasti të re.

Ai qeveris vetëm 800.000 subjekte, por ai mban çelësin e një situatë politike që është e mbushur me mundësitë më të rrezikshme për prishjen e paqes europiane.

Ai është i rrethuar nga të gjitha anët nga shtete të reja të fuqishme dhe ambicioze që shkëlqejnë në mënyrë ogurzezë mbi njëri-tjetrin dhe e shikojnë atë me ankth. Në njërin anë qëndron një Jugosllavi e zgjeruar dhe ambicioze nën diktaturën e mbretit Aleksandër, e cila kërkon dëshpërimisht të hapë një dalje në Mesdhe.

Nga ana tjetër, figura e madhe dhe e frikshme e Musolinit bllokoi rrugën drejt kësaj daljeje. Mes të dyve, mbretëron një armiqësi kërcënuese, në rritje dhe e rrezikshme. Të dy po luftojnë për kontrollin e Adriatikut që të çon në Mesdhe dhe në fuqizimin botëror.

Mbreti i ri i Shqipërisë dhe mbretëria e tij e sapolindur shtrihen gjeografikisht mes këtyre dy rivalëve të egër. Këto dy kombe po shikojnë me ankth ngritjen e këtij Mbreti të ri; të dy janë rivalë për miqësinë e tij dhe secili është xheloz për çdo shenjë favorizimi që mund t'i tregojë tjetrit.

DAILY EXPRESS (1930) / “DIKTATOR ËSHTË AI QË SHPËRFILL KUSHTETUTËN...”, INTERVISTA EKSKLUZIVE ME MBRETIN ZOG I NË SHQIPËRI



Në atë rivalitet qëndron fara e telasheve për Evropën. Musolini ka shënuar suksesin e parë duke i dhënë hua mbretit Zog 2,000,000 £.

Në këmbim, Italia ka fituar ndikimin tregtar dhe të drejtën për të trajnuar ushtrinë shqiptare. Si pasojë ka tërbim dhe hidhërim në Jugosllavi. “Shkëndija e Ballkanit” më përshkroi Shqipërinë një zyrtar i lartë britanik. Ajo është Belgjika e Evropës Lindore.

Mbreti Zog ka armiqet e tij xhelozë, të cilët përdorin metoda të çuditshme për të shkatërruar prestigjin e tij dhe për të minuar mbretërinë e tij. Raporte të çuditshme kanë qarkulluar për shumë muaj nëpër kryeqytetet e Evropës se ai po vdiste nga një atentat i ngadaltë në pallatin e tij nga helmi i administruar në mënyrë misterioze dhe se mbretëria e tij, e copëtuar nga revolta, ishte gati të shpërfaqej.

Erdha në Shqipëri për të mësuar të vërtetën për këtë monark të ri dhe aktivitetet e tij. Për dy orë sot, Zogu i Parë më tregoi për sprovat e tij, punën e tij dhe ambiciet e tij për popullin e tij. Ai u përgjigj me gjallëri pyetjeve të mia, por me një vigjilencë të jashtëzakonshme.

Kjo intervistë me një sovran në pushtet ishte, për informalitet, më e veçanta në përvojën time.

Ne u ulëm përballë njëri-tjetrit në një tavolinë të vogël pune, të mbushur me letra, në fund të një dhome të gjatë, të mobiluar thjesht në pallatin dykatësh, me ngjyra, i cili është thjesht një vilë e vogël, me shumë pak pretendime.

Mbreti Zog është një i ri i pashëm, shtatlartë, i zhdërvjellët, me pamje nervoze, me ngjyrë të zbehtë, me mustaqe paksa të gjata, siç është stili shqiptar. Ai u ul në një karrige të madhe, si një fron, të gdhendur me shqiponjën dykrenare shqiptare dhe kishte veshur një uniformë të

thjeshtë kaki pa asnjë dekoratë të vetme.

Unë shpreha habinë e këndshme që e pashë atë në një shëndet kaq të mirë, pasi raportet e këqija kishin shprehur të kundërtën.

“Unë nuk jam i befusuar dhe as i mërzhitur nga këto forca”, u përgjigj mbreti. “Shumë forca po punojnë kundër meje në një klimë kërcënimesh, sepse unë e kam bashkuar vendin tim dhe i kam kthyer fytyrën drejt paqes dhe përparimit. Këto forca inkurajohen në qarqe të fuqishme dhe janë aq tinëzare, saqë mjetet që kam në dispozicion i shoh shumë të dobëta për t'i luftuar ato.”

“A do të më tregojë Madhëria juaj pikat kryesore të politikës suaj?”

“Me kënaqësi. Është, me një fjalë, liri dhe përparim për vendin tim dhe paqe me fqinjët e mi. Emri i lashtë i vendit tim është, ju kujtohet, Illyria, që do të thotë liri. Ne kemi luftuar dhe vuajtur për të për qindra vjet kundër pushtimit dhe shtypjes së vazhdueshme të huaj.”

“Po politika juaj e brendshme?”

“Kjo është e thjeshtë. Ju e dini se për shekuj vendi im ka jetuar në një gjendje kaosi për shkak të keq-qeverisjes së huaj. Unë kam ndërmend ta ndryshoj atë. Politika ime është ajo e rindërtimit – të përpiqem të kapërcej dekadencën disashekullore dhe ta sjellë Shqipërinë në përputhje me idetë dhe nevojat moderne.”

Mbreti u përkul dhe buzëqeshi me mirënjohje ndërsa unë e përgëzoja për këtë veprimtari të jashtëzakonshme. Rrugës për në kryeqytetin kisha parë ndërtesa, rrugë të ndërtuara, laboratorë kërkimorë bujqësorë dhe shumë biznese të tjera të reja.

“Kishte gjithashtu vështirësi fetare,” shtoi ai.

“Në Shqipëri ka tre fe të ndryshme dhe të gjitha ishin të përziera në politikë. Unë tani e kam ndarë plotësisht fenë nga shteti. Unë kam dekretuar lirinë dhe barazinë e plotë fetare. Vetë shteti nuk ka fe zyrtare dhe njerëzit janë të lirë të bëjnë çfarë të duan.”

Unë iu referova pozitës së gruas. Kisha lexuar se në Shqipëri pozicioni i tyre tradicional ishte ai i “orendive”. “A do të garantoni barazi gjinore si në Perëndim?” — e pyeta unë.

“Unë besoj në lirinë kulturore të grave dhe barazinë e tyre përpara ligjit,” ishte përgjigja, “por nuk mendoj se ato duhet të marrin pjesë në politikë. Dua t'i edukoj gratë, por edhe t'i mësoj që të jenë nëna të mira dhe menaxhere shtëpie. Unë dua që gratë shqiptare të jenë gra të mira – si ajo.”

Mbreti u kthye dhe tregoi portretin e një gruaje të pashme në mur, në moshë të mesme. Ai u përkul pothuajse në mënyrë të padukshme para fotografisë. “Ajo është nëna ime,” — tha ai thjesht.

I përmenda se feja e fëmijëve dhe martesat kanë qenë të zakonshme në Shqipëri, fejmimet e fëmijëve edhe para lindjes. “Unë e kam shfuqizuar të gjithë këtë me një dekret të veçantë dhe” — kjo me një ndjesi krenarie — “është pranuar nga të gjithë pavarësisht zakonisht shekullor.”

Mendoj se ky është një nderim i veçantë për aftësinë dhe ndikimin e tij. “Thuhet se sundimi juaj është një diktaturë, një formë qeverisjeje që nuk është shumë e popullarizuar në Perëndim.” Mbreti Zog ktheu sytë e tij të shkëlqyeshëm nga unë : “Varet se çfarë do të thuash të dish se si qeverisen vendet e tjera, por unë e njoh vendin tim dhe njerëzit e mi.

Ashtu si rrobat janë bërë për t'iu përshtatur personit, ashtu edhe sistemet qeverisëse janë krijuar për t'iu përshtatur kombeve individuale. I dhashë vendit një qeveri kushtetuese – një kabinet dhe një parlament. Por qeveria duhet mbajtur nën kontroll të rreptë dhe qeveria ime është përgjegjëse ndaj Kurorës. Është e vërtetë që unë zgjedh kabinetin, por është përgjegjës edhe para Parlamentit. Diktator është ai që shpërfill Kushtetutën. Por unë nuk do të toleroj ‘lobimet qeverisëse’”, shtoi ai ndjeshëm.

E pyeta se çfarë mendonte për mbretërimin në përgjithësi dhe si kishte ndikuar tek ai. “I vetmi ndryshim që ka bërë për mua,” tha ai i zymtë, “është se në vend që të punoj shtatë apo tetë orë në ditë, tani punoj tetëmbëdhjetë dhe mbaj përgjegjësinë e të gjithë shtetit. Unë jam vetëm një punëtor i thjeshtë që bëj punën time. Kjo është gjithçka do të thotë për mua mbretërimi.”

Ai donte të ulej dhe të bisedonte, por duke parë masën e letrave në tavolinën e tij, u ngrita për t'u larguar.

I dhashë lamtumirën time. “Shpresoj se do të vini sërish,” tha ai.

Zogu I, Mbreti i Shqiptarëve, është një i ri shtatlartë me inteligjencë të jashtëzakonshme. Unë parashikoja që do të dëgjojmë shumë për të dhe se ai do të bëhet një nga shtetarët më të talentuar në Evropë.

LUTFI DERVISHI

ATA QË NUK KËNDUAN...

Çfarë do të ndodhte nëse do të reagonim po aq shpejt dhe fuqishëm për disa që nuk janë larguar nga Shqipëria me dëshirë, por janë përballuar me presione dhe ndëshkime?

Edvin Prifti, është një kardiokirurg. Profesionin e tij lidhet me shpëtimin e jetëve. Është i pari që foli për pandeminë dhe vaksinat, por sot përballë me drejtësinë pas katër vjet hetimesh dhe përgjimesh. Është mjeku që ka operuar 7300 pacientë. Asnjë ditë me pushtet, asnjë tender apo abuzim me fonde publike. Mbi të sot rëndojnë katër akuza. Mbi ne rëndon indiferenca.

Ilir Allkja, mjeku që ngriti zërin për kushtet në spitale, dhe u përjashtua nga puna. Kur atij ju komunikua pushimi nga puna ne ishim me pushime.

Emiliano Nuhu, oficeri i policisë që denoncoi abuzimet dhe rreziqet që vijnë nga korrupsioni dhe abuzimi me pushtetin, nga lidhja e bandave me politikën. Sot ka fituar azil politik. Ai nuk heshti, por heshtëm ne.

Antoneta Sevdari, një prokurore që guxoi të jetë e ndershme dhe e pavarur në një sistem drejtësie të kalbur do të ishte sot pa punë nëse nuk do të ishte Gjykata e Strasburgut. Asnjë zë për të mbrojtur atë. Asnjë përgjegjësi për ata që e "dhunuan"

Dritan Zagani, është oficeri që denoncoi lidhjet e krimit me politikën. Si shpërblim u përball me persekutim të paprecedentë publik



deri edhe nga kryeministri. Sot është azilant politik. Ne bëmë melodrama me denoncimet e tij. Agron Tufa, poet, shkrimtar mund të ishte sot këtu. Por kërcënimet me jetë për punën e tij si drejtues i Institutit të Përndjekurve Politikë e detyruan të kërkonte azil. Heshtëm.

Pal Trashaj i dha fund jetës pas vitesh trokitje në dyert e drejtësisë shqiptare. Po ta kishim dëgjuar sot do të ishte mes nesh.

Ervin Saliq është deputet që po bën burg për "kallëzim të rremë publik". Është i pari që vuan dënimin ekstrem për këtë "vepër penale". Për këtë heshtëm është e "justifikuar" sepse ky është politikan.

Apostol Vaso, një mjek i rrallë që u largua nga puna për "Mungesë kreditesh" ndërkohë që kishte punime shkencore të botuara në revistat më prestigjioze të mjeksisë. Është mjek që shëron dhimbjet, por ne jemi të mpirë dhe nuk

ndjejmë më dhimbjen tonë le pastaj të tjetrit.

Këta individë (sigurisht që ka edhe të tjerë) nuk janë thjesht emra; janë simbol i indiferencës dhe mungesës së kujdesit për të ngritur zërin ndaj së keqes. Ata nuk zgjodhën të largoheshin, por të shërbenin.

Nëse nuk do të kishim heshtur a do të kishim për ta shpërfillje, për-buzje dhe akuza?

Nëse do të kishim protestuar për ta ndoshta do të kishim tharë

moçalin ku heronjtë zhduken dhe nostalgjia kthehet në dekor për indiferencën tone gjenetike që aktori njohur Mehdi Malkaj e sintetizoi në pyetjen: "e ç'më duhet mua"?

"Gjarperi që nuk më kafshon mua paste jetën e gjatë". Apo siç thoshte Shvejku "e ç'më duhet mua se ç'bëj unë?"

Bëjmë shumë mirë që flasim për ata që ikin, por gjynah që nuk ngremë zërin edhe për ata që nuk e kanë zërin e bukur për të kënduar.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



Akoma nuk keni një website?

Dotech
website 

**Mos lejoni që Viti i Ri 2025
tu gjejë pa një website**

**Për çdo konsultim
mund të vini tek zyrat tona**

The 
Albanian

**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**



**Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT**



AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI
NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD,
LONDON, E13 8HT**

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

VETON SURROI

1.

Do të ketë me gjasë mbledhje të ardhshme mes parlamenteve të Kosovës e Shqipërisë në të ardhmen, dhe takimi i ardhshëm do të duhej të mbahej në Tiranë. Ndoshta do të ishte mirë që nga tani të vendosej një standard i ri këmbimi mendimesh dhe që fjalimi i ardhshëm i kryeministrit të Kosovës të MOS i përmbajë pikat e poshtëshënuara. Po të lexoheshin, do të kuptoheshin me të drejtë nga vendi nikoqir si tejkalim i tonit miqësor, të sovranitetit të vendit e të respektit të ndërsjellë që duhet të ekzistojë mes dy vendeve.

- Kosova është në vendin e parë të rritës ekonomike, avancimit të demokracisë, luftës kundër korrupsionit e krimit të organizuar krahasuar me të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Përderisa fqinjët tanë shënojnë prapakthim e disa janë nisur në drejtim të autokracive zgjedhore – madje me ndihmë të madhe edhe të krimit të organizuar e narkotrafikut – Kosova po ecën përpara në konsolidimin e vet demokratik.

- Në Kosovë kemi ndjeshmëri të veçantë ndaj Shqipërisë, që shumë prej nesh e kemi quajtur “shteti amë”. Ndonëse realiteti i sotëm është i dy shteteve, dashuria amtare do të jetojë, së paku për gjeneratën tonë.

- Mu për këtë dhe nga përkrahja historike që ndiejmë për procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nuk kemi si të mos i ndajmë këtu vëllazërisht me ju brengat tona për gjendjen e Shqipërisë dhe të ofrojnë ndihmën tonë të pakursyer kurdo që të na kërkohet.

- Përpjekja monumentale e miqve tanë për të vendosur sundimin e ligjit në Shqipëri ka dhënë dhe po jep rezultate të dukshme. Kosova po kalon nëpër një proces të mundimshëm të zhvillimit të pavarësisë së sistemit

FJALIMI QË KRYEMINISTRI I KOSOVËS NUK DUHET TA MBAJË NË TIRANË MË 2025



prokurorial e gjyqësor dhe andaj dimë se sa janë të ndjeshme këto për Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, shohim me brengosje mundësinë që drejtësia të përdoret si mjet politik. Në këtë drejtim e shoh si brengosëse që Kuvendi i Shqipërisë deri më sot nuk ka bërë një rezolutë, të arritur me konsensusin e të gjitha partive politike, që do të vlerësonte standardet etike e profesionale të sistemit të drejtësisë. Në rast se arrini një konsensus për rezolutë, ta keni të sigurt përkrahjen tonë në Kuvendin e Kosovës.

- Të jem krejtësisht i qartë, ne përkrahim plotësisht punën e SPAK-ut, të themeluar me ndihmën e drejtëpërdrejtë të miqve tanë ndërkombëtarë, në radhë të parë SHBA-së. Dhe, nuk do të përkrahim

kurrfarë përpjekjeje për ta zhbërë këtë institucion sepse, siç ka thënë moti presidenti ynë historik I. Rugova, “shtëpia mbahet me miq”.

- Por, vendi ynë, Kosova, ka ndjeshmëri të veçantë ndaj çfarëdo që i përngjet përndjekjes politike. Dhe, ndonëse përkrahim plotësisht pavarësinë e SPAK-ut dhe të gjykatave, nuk kemi si të mos pyetemi për fatin e liderëve të opozitës që po kalojnë nëpër procese juridike, që dikush mund t’i vlerësojë si selektive.

- Andaj, nuk ka si të mos e përsërisë ngërçin që e kam këtu në foltore e të cilin po e ndaj me ju, rreth unitetit historik ndër ne shqiptarët. Përderisa po zhvillohen këto procese gjyqësore,

nuk duhet harruar se Shqipëria e sotme demokratike nuk do të kishte arritur në këtë pikë pa kontributin parësor të liderit të parë opozitar kundër komunizmit, Sali Berisha, dhe liderit të parë ndër socialistët e rinj që i kaloi të gjitha postet me përgjegjësi të lartë në vend, Ilir Meta. Sidoqoftë, është gjithashtu e rëndësishme të theksojmë një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm në këtë debat. Pa angazhimin dhe përkushtimin e Sali Berishës dhe Ilir Metës në momentet kyç të historisë së Shqipërisë, shumë nga arritjet që kemi sot mund të kishin mbetur të papërfunduara.

- Dhe, dua të ndaj me ju në fund, edhe një preokupim për të cilin jemi të gatshëm të ndihmojmë. Kosova, si një shtet që ka kaluar një periudhë të

vështirë të ndarjes dhe sfidave të brendshme, ka një angazhim të thellë për mbështetje dhe ndihmë në ruajtjen e të drejtave të pakicave. Kjo është arsyeja pse, si Qeveri e Kosovës, ne ofrojmë një bashkëpunim të ngushtë për hartimin e një Statuti të Bashkësisë së Territoreve Grekofone të Shqipërisë. Ky është një hap i rëndësishëm për të forcuar identitetin kulturor dhe gjuhësor të kësaj pakice dhe për të siguruar që ata të gëzojnë të drejtat e plota, ashtu siç duhet të jetë për çdo komunitet në Shqipëri. Ne jemi të gatshëm të kontribuojmë me eksperiencën dhe njohuritë tona për të ndihmuar në krijimin e një baze ligjore dhe institucionale që do të mbrojë këto të drejta dhe do të mundësojë një integrim të plotë të grekofonëve në shoqërinë shqiptare.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



Mos bini në kurthin e të ndenjurit gjithë ditën pa ngrënë me idenë se do hani në darkë, pasi në këtë mënyrë do të dalë jashtë kontrollit sasia e ushqimit gjatë darkës festive. Është mirë të mos shkoni në tryezën e Vitit të Ri të uritur.

Ajo jep këshilla për çdo detaj duke filluar nga pjatat mesore, sallatat, pijet dhe aq më tepër për gjelin e detit, specialiteti që nuk mungon kurrë në tryezat e shqiptarëve në darkën e Vitit të Ri.

Dhe rekomandimet e dietologes për një darkë sa më perfekte e nisin pikërisht me pijet ato që nuk duhet të mungojnë në tryezë. "Jo pije me gaz, me përjashtim të ujit të gazuar, pasi shtojnë kalori të cilat nuk ngopin.

Të konsumohet ujë pas çdo vakti gjatë ditës së festave dhe ky të shoqërojë çdo pije alkoolike që do të preferoni", - pohon dietologja e cila nuk lë pa përmendur verën e mirë për të cilën thotë se është një pije e preferuar dhe e shëndetshme.

Nuk jam kundër rakisë dhe whisky-t, nëse konsumohen me masë dhe shoqërohen vazhdimisht me ujë dhe me ushqim. Kombinimi i alkoolit me mjaltë sipas saj ndihmon në metabolizmin e alkoolit.

Ndërsa sa i përket gjelit të detit dietologja ka dhënë shpjegime të mirë organizuara se si duhet ta gatujmë për 8 persona. Mbushja e gjelit me shumë llojshmëri përbërësish, si të gatujmë lëngun e mishit dhe shumë detaje të tjera. Konkretisht recetat.

MESORE:

Sallatë ruse me fasule, bizele, karota etj dhe majonezë shtëpie
Salcë kosi të bërë vetë me pak majdanos, kas-travec, vaj ulliri dhe hudhër

Perime të zgarës: specatë kuq, kunguj, qepë, domate dhe pak gjizë pa yndyrë

Byrek me presh dhe gjizë

Sallatat:

Jeshile, rukola, spinaq të freskët me djathë dhie, fara lule dielli
Lakër e bardhë, karrote, stafidhe, vaj, limon
Lakër e kuqe, e marinuar dhe molle jeshile
Pjata kryesore, gjel deti

Pjata kryesore Gjel deti:
Receta: gjel deti i mbushur
Ingredientët për 8 persona:
6-7kg gjel deti
Mbushja:
1 ½ kupë oriz
1 qepë të grirë
3/4 kupë selino të prerë

2 kupa kërpudha të freskëta në feta të holla

1 mollë jeshile në feta

4 hudhra të grira
½ kupë arra
6 kajsi të thara të prera në 4sh



½ kupë stafidhe
½ kupë majdanos i freskët
½ kupë + 1 lugë të madhe brodo pule kripe, piper
Lëngu i mishit:
6 kupa brodo pule
2 karota të mëdha në copëza
2 qepë prerë trashë
2 kërcj seleri
qafa, krahët e gjelit
1/3 kupë miell i përzier me ujë
1 lugë të madhe rozmarinë të freskët të prerë
2 lugë të vogla timio (thimari)
kripë, piper

Përgatitja e mbushjes

Zieni 3½ kupa ujë me kripë. Hidhni orizin, ziejeni pak dhe kullojeni. Vendoseni në një tas të madh.
Zieni 1 luge të madhe brodo me qepën dhe shtoni më pas kërpudhat dhe selinon. Gatuan për 2-3min.
Përzieni të gjithë përbërësit e tjerë dhe hidhni kripë – piperin. Gjithmonë mbusheni menjëherë përpara pjekjes.

Gjeli

Shpëlani, thani gjelin.
Ndizni furrën në 180 gradë C. Mbushni gjelin.
Lyeni gjelin me pak kripë, piper.
Vendoseni në furrë me gjoksin poshtë.
Vendosni në teps 1 kupë brodo.
Kontrollojeni derisa te bindeni që është pjekur. Lëngu:

Zieni të gjithë përbërësit pa miellin, timion, rozmarinen, kripën dhe piperin për rreth 1 orë në zjarr mesatar.
Kulloni ujin duke larguar copat e ngurta. Zieni ¼ kupë brodo në një tigan dhe hidhjeni nga pak miellit. Vazhdoni të hidhni pjesën tjetër të brodos pak nga pak duke e mbajtur mbi zjarr të ulët.
Shtoni rozmarinën dhe gatujeni për 20min. Spërkateni me timio (thimari), kripë dhe piper.

Ëmbëlsira, 200-300 gramë!

Ëmbëlsirat nëse konsumohen në një porcion normal (200-300gr) ofrojnë diku te 600 – 700 kalori për të cilat do duheshin rreth 2 orë vrap që të harxhohen! E vetmja gjë që mund të bëni është të kurseni disa ushqime të nesërmen!

DARKA E VITIT TË RI 10 KESHILLA REALE SI TË HANI PER QEJF DHE MOS MAJMENI...

Netët festive të ndërrimit të viteve dhe ditët e para të Vitit të Ri, përveçse argëtimit, na sjellin dhe ... shëndet. Ky vjen mes drekave dhe darkave pafund me miqtë e të afërmit, si edhe kokëçarjes së munguar të punës. Ky shëndet duket se na zbukuron gjatë këtyre ditëve, por na bën të dukemi keq nëse e teprojmë me ushqimin.

1 – Respektoni ritmin e ngrënies:

Edhe në pushime sundon regjimi tradicional: mëngjes, drekë dhe darkë. Shmangni ushqimet si ngrënie vaktesh në mes tyre.

2 - Hani çdo gjë në sasi të vogla

Gjatë festave mundohuni jo të ngopeni shumë, por të shijoni sa më shumë asortimente, çka do të thotë se duhet që të hani në sasi të vogla dhe gjëra sa më të shumëllojshme.

3 - Fruta dhe perime sa më shumë

Këto duhet të zënë shumicën e ushqimit të festave, duke siguruar për ju kështu sa më shumë fibra dhe ujë, qoftë edhe një luleshtrydhe. Sepse uria nuk është çdo gjë, imazhi vlen shumë, ashtu si kuzhinierët që ngopen me aromën e asaj që gatujnë, ju mund të ngopeni me pamjen e lezeçme të një darke festive.

4 - Pjata të vogla dhe të zbukuruar

Përdorni sa më shumë pjatëza të vogla, të lezetshme me gjëra që kanë shije të veçantë. Pra qëndroni larg pjatave të mbushura plot, por preferoni të voglat që ju bëjnë të shijoni në to, qoftë edhe një luleshtrydhe. Sepse uria nuk është çdo gjë, imazhi vlen shumë, ashtu si kuzhinierët që ngopen me aromën e asaj që gatujnë, ju mund të ngopeni me pamjen e lezeçme të një darke festive.

5 - Jo ushqime të rënda dhe me yndyrna

Mundohuni të hani sa më shumë

peshk, mish të lehtë dhe aspak mish të yndyrshëm. U thoni Jo ushqimeve të rënda gjatë periudhës së festave.

6 - Kursejini sa më shumë kaloritë

Duhet t'u rezistoni kalorive, për shembull, të mos hahet buka e as brumëra të tjera apo të shtoni krem për garniturë mbi kekun që njihet si Panettone.

7 - Shpërndajeni ushqimin si duhet

Shpërndajeni ushqimin siç duhet gjatë ditës suaj, pa u munduar të krijoni shumë vakte në një kohë të ngjeshur.

8 - Jo darkave të bollshme

Gjatë ditëve dhe netëve fesdive, u thoni Jo darkave të bollshme dhe përiquni që në këtë vakt të hani vetëm ndonjë ëmbëlsirë apo gjë të lezetshme, me një shije speciale.

9 - Mos harroni edhe të lëvizni

Edhe pse jeni më shumë në shtëpi apo ambiente të mbyllura, mos harroni që të lëvizni gjatë periudhës së festave, qoftë edhe brenda tyre. Mos rriini vetëm pasivë.

10 - Të jeni gati për rinisjen

Mos harroni të bëni një plan për janarin, lëvizjet, punën, mendime këto që duket sikur ju bezdisin kur jeni me pushime, por në fakt, ua mbajnë trurin të freskët dhe të ingranuar, larg një pushimi total që mund t'ju bënte më shumë keq se mirë.



Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059



AKOMA NUK KENI

NJË WEBSITE?

Beji vetes një dhuratë

**MOS LEJONI QË VITI I RI 2025
TU GJEJË PA NJË WEBSITE**

***Dot*tech**
website 



**020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545**

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT